**Karriera politike:** 1995 e vazhdim: anëtar i PS-së; anëtar i Komitetit Drejtues të PS-së, Librazhd; anëtar i Komitetit të Përgjithshëm të FRESSH. Maj 2006 - Nëntor 2006: anëtar i Komisionit Hetimor për hetimin e tregut monopol të telefonisë celulare dhe përgatitjen e rekomandimeve për liberalizimin e këtij tregu në Shqipëri.

**Karriera jopolitike:** 2002: Departamenti për Marrëdhëniet Ndërkombëtare në PS and anëtar i Bordit të ALPSA (Shoqata Shqiptare e Shkencave Politike).

## BANO, Ilir



Datëlindja: 11.5.1951  
Vendlindja: Lushnjë  
Zona Nr.: 64 -  
Lushnjë  
Qarku: Fier

**Adresa:**

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234607

**Grupi Parlamentar:** PD – Nënkrjetar.

**Veprimtaria parlamentare aktuale:** Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin – Anëtar. Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, anëtar. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik (anëtar zëvendësues). Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (anëtar zëvendësues). Komisioni Hetimor "Për hetimin e objektit dhe procedurave të kontratës së privatizimit të Albtelekomit për periudhën 2001 e në vijim" - Nënkrjetar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti Gjeologji-Miniera - 1974  
**Karriera politike:** 1997 e vazhdim: Anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së; 1999-2005: Sekretar organizativ i PD-së; 2005 e vazhdim: Sekretar për burimet njerëzore në PD.

Maj 2006 - Nëntor 2006: Nënkrjetar i Komisionit Hetimor për hetimin e tregut monopol të telefonisë celulare dhe përgatitjen e rekomandimeve për liberalizimin e këtij tregu në Shqipëri.

**Karriera jopolitike:** 1973-1983: Inxhinier në Ndërmarrjen e Shpim-Kërkimit, Lushnjë; 1983-1985: Instituti Teknologjik i Naftës, Patos; 1985-1987: Inxhinier në Shpim-Kërkim, Patos; 1987-1991: Instituti Teknologjik i Naftës, Patos; 1991-1993: Ministria e Burimeve Minerare e Energjitike.

**Tituj:** Doktor i Shkencave dhe Mjeshtër Kërkimesh

**Publikime:** Botime të shumta në revistën "Nafta e Gazi"; studime e projekte.



## BASHA, Lulzim



Datëlindja: 12.6.1974  
Vendlindja: Tiranë  
Zona Nr.: 33  
Qarku: Tiranë

Adresa:  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë

**Grupi Parlamentar:** PD

**Funksioni aktual:** Ministër i Jashtëm.

**Edukimi:** Drejtësi në Universitetin e Utrechtit, Hollandë, specializuar në të Drejtën Europiane dhe Ndërkombëtare Publike.  
**Karriera politike:** Shtator 2005 - Prill 2007: Ministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit; 2005(maj) e vazhdim: anëtar i Kryesisë së PD-së; zëdhënës i Fushatës Zgjedhore 2005; 2005(prill) e vazhdim: anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së.

**Karriera jopolitike:** 2005(janar) e vazhdim: Koordinator i Komitetit të Orientimit të Politikave (KOP), PD-Tiranë; 2002(nëntor)-2005(janar): këshilltar special për Tranzicionin në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut, Prishtinë Kosovë; 2001(tetor)-2002(nëntor): Zëvendës Shef i Kabinetit të Drejtorit të Departamentit të Drejtësisë, UNMIK; 2000(korrik)-2001(tetor): këshilltar ligjor në Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut; 1998(maj)-1999(korrik): pjesëtar i skuadrës së hetimit të krimeve të luftës nga forcat serbe në Kosovë: Tribunali Ndërkombëtar për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi.

**Tituj:** Meester in de Rechten (ekuivalent i LLM).

**Publikime:** Publikime të ndryshme dhe fitues çmimesh ndërkombëtare në fushën e të drejtës Ndërkombëtare Publike

## BEJA, Fatos



Datëlindja: 29.11.1948  
Vendlindja: Vlorë  
Zona Nr.: 71  
Qarku: Fier

Adresa:  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228248

**Grupi Parlamentar:** PD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Byroja e Kuvendit – Nënkyetar.

Këshilli për Legjislacionin – Anëtar.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut - Kryetar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, dega Filologji - 1970; Kurse specializimi për Diplomaci, Gjenevë - 1992 dhe Uashington - 1993; për Minoritetet, Budapest -1991 dhe Vjenë - 1995; për të Drejtën Humanitare Ndërkombëtare, Pragë - 1991; për Mediat televizive, Paris – 1996.

**Karriera politike:**

1992-1997: Këshilltar Diplomatik i Presidentit të Republikës;

1996-1997: deputet i PD-së;

1997-2005: anëtar i Kryesisë së PD-së; 1997-1999: sekretar për Organizimin e PD-së;

1999-2001: sekretar për Zgjedhjet dhe Burimet Njerëzore i PD-së; 2001-2005, deputet, nënkryetar i Komisionit Parlamentar të Ligjeve; Shtator 2005 - Prill 2006: anëtar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

**Karriera jopolitike:**

1971-1982: përkthyes e redaktor në Agjencinë Telegrafike Shqiptare;  
1982-1985: redaktor i Revistës Arkeologjike "Iliria";

1985-1992: Bashkëpunëtor Shkencor në Institutin e Gjuhësisë dhe Letërsisë, Akademia e Shkencave;

1978-1991: pedagog i jashtëm në UT.

**Tituj:** Doktor i Shkencave Filologjike

**Publikime:** Autor teksti universitar, monografie e kumtesash shkencore, artikuj të shumtë në shtypin shkencor, letrar e politik.

---

## BEJTAJ, Engjell



**Datëlindja:** 15.3.1954

**Vendlindja:** Berat

**Zona Nr.:**

**Lista shumëmeëore**

**Adresa:**

*Kuvendi i Shqipërisë*

*Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"*

*Tiranë*

*Tel.: 00355 4 234610*

**Grupi Parlamentar:** PSD – Nënkrjetar.

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, anëtar.  
Maj 2007-... : Anëtar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë - 1974-1979;  
Specializim për kirurgji të përgjithshme -1983-1986; Specializim për kirurgji abdominale, Güssing-Austri - 1993.

**Karriera politike:**

1991 (Prill): anëtar i PSD-së; 1992: anëtar i këshillit Drejtues Kombëtar të PSD-së; 1996: anëtar i Kryesisë së PSD-së; 2000: sekretar i Përgjithshëm i PSD-së; 2004: nënkryetar i PSD-së; 2003 (dhjetor)-2005 (shtator): Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale.

**Karriera jopolitike:**

1981-1983: mjek, Qendra shëndetësore Kute Mallakastër; 1986-1989: mjek kirurg në Spitalin civil, Fier; 1989-1997: shef i Shërbimit Kirurgjikal në Spitalin civil, Fier; 1991-1993: Drejtor i Spitalit civil, Fier.



## BELLO, Marko



Datëlindja: 12.9.1961

Vendlindja: Berat

Zona Nr.: 76

Qarku: Berat

Adresa:

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë*

**Grupi Parlamentar:** PSSH

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, anëtar.

Komisioni i Posaçëm për Integrimin në NATO, anëtar.

Komisioni Hetimor "Për hetimin e objektit dhe procedurave të kontratës së privatizimit të Albletekomit për periudhën 2001 e në vijim" - Kryetar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori-Filogji.

**Karriera politike:**

Maj 2006 - Tetor 2006: anëtar i Komisionit Hetimor për Hetimin e Shkarkimeve në Administratë.

Dhjetor 2003-Shtator 2005: Anëtar i KPD-së të PS dhe Ministër Shteti për Koordinimin; Shkurt 2002- Korrik 2002: Ministër Shteti për Integrimin; 2000: Anëtar i PS-së; 2000: Zv/Ministër i Mbrojtjes; 1997-2000: Ambasador i RSH në Ruman.

**Karriera jopolitike:**

1987: Diplomaci, 1989: Diplomat, Sekretar në Ambasadën e RSH-së në Ruman, 1993: Korrespondent i BBC-së, and 1994-1997: Korrespondent i Agjencisë së Lajmeve Reuters.

**Tituj:** Doktor i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

## BERISHA, Sali



**Lindur me 15 tetor, 1944**, Sali Berisha u diplomua me rezultate të shkëlqyera në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tiranës në vitin 1967. Ai u specializua në degën kardiologji dhe më pas u emërua si asistent/profesor mjekësie në të njëjtin universitet dhe mjek kardiolog në Spitalin e Përgjithshëm të Tiranës. Gjatë viteve '70, z. Berisha u dallua për punën kërkimore në fushën e kardiologjisë në Shqipëri dhe u emërua profesor kardiologjie në universitetin e Tiranës. Në vitin 1978 ai fitoi një bursë nëntë muajore nga UNESCO për studime të avancuara dhe trainime në Paris. Pas kthimit në Shqipëri, Berisha filloi një program kërkimor për homodinamikën që tërhoqi vëmendjen e shumë kolegëve europianë. Në vitin 1986 u zgjodh anëtar i Komitetit Europian për Kërkime Mjekësore me qendër në Kopenhagën, me të cilin punoi për përpunimin e strategjive kërkimore shkencore "Shëndet për të gjithë". Studimet shkencore ndërkombëtare në kardiologji të z. Berisha ishin origjinale dhe të rëndësishme; ato u botuan në gazeta dhe revista mjekësore prestigjioze në Europën Perëndimore. Në vitin 1989 iu dha titulli Profesor në Universitetin e Tiranës. Me vdekjen e diktatorit Enver Hoxha në vitin 1985, Sali Berisha shpresonte se udhëheqësi i ri i vendit, Ramiz Alia do të ndryshonte rrugën e paraardhësit të tij dhe politikës Staliniste dhe do të inkurajonte ndryshimin. Por, së bashku



me një numër që rritej dita-ditës intelektualësh, studentësh dhe punëtorësh të rinj, ai u zhgënjye kur këto shpresa nuk i'u realizuan. Në vitin 1989, ndërkohë që vendet e Europës Lindore filluan të braktisin komunizmin, z. Berisha dhe avokatë të tjerë të reformës u bënë më të hapur në thirrjet e tyre për ndryshim në Shqipëri. Në tetor 1989 në një intervistë në Televizionin Shqiptar, z. Berisha e nxiti regjimin të fillonte një program të gjerë liberalizimi por intervista e regjistruar nuk u lejua të transmetohej. Të fillim të vitit 1990, Berisha e nxiti regjimin të zgjeronte qëllimin e reformave përfshi dhe krijimin e një sistemi politik demokratik shumëpartiak dhe të një ekonomie tregu. Në fillim të viteve '90, z. Berisha ishte dalluar si një nga personat më respektuar të lëvizjes për reformë në Shqipëri. Në një intervistë për gazetën e Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë, intervistë e cila u botua gjithashtu dhe në shtypin ndërkombëtar, Berisha kërkoi që të merrnin fund barrierat e mbetura ndaj lirisë së mendimit dhe shprehjes, që shqiptarëve t'u garantohej e drejta të udhëtonin lirish brenda dhe jashtë vendit, dhe që Shqipëria të braktiste politikën e saj të jashtme izoluese. Në gusht të vitit 1990 në një takim të intelektualëve të vendit të mbledhur nga Presidenti Ramiz Alia, z. Berisha e nxiti Partinë e Punës së Shqipërisë të hiqte nenin 3 të Kushtetutës komuniste i cili sanksiononte që Partia e Punës kishte pushtet të plotë, të njëjtte Kartën e të Drejtave të Njeriut, të hartonte një Kushtetute të re demokratike, dhe të hiqte të gjitha monumentet e Stalinit në të gjithë vendin. Në një artikull të botuar në gazetën "Bashkimi" me 17 shtator të vitit 1990, z. Berisha dënoi, ato që ai i quajti "reforma kozmetike" të regjimit të Ramiz Alisë, të cilat i kishin shërbyer vetëm përkeqësimit të gjendjes në vend. Pa pluralizëm politik, argumentoi ai, nuk mund të ketë demokraci të vërtetë në Shqipëri. **Në dhjetor të vitit 1990**, z. Berisha u bashkua që ditën e parë me demonstratat e studentëve që detyruan qeverinë të miratonte krijimin e një sistemi shumëpartiak. Z. Berisha u bë drejtuesi i Partisë Demokratike (PD), partia e parë dhe më e madhja e opozitës së re. Ai u zgjodh zyrtarisht kryetar i PD-së në shkurt të vitit 1991 në kongresin e parë kombëtar të partisë. Megjithëse PD-ja nuk ishte në gjendje të krahasohej me burimet financiare dhe organizative të PPSH-së, në zgjedhjet parlamentare në mars të vitit 1991 fitoi 39% të votave popullore dhe doli si partia kryesore e opozitës në Kuvendin Popullor. Megjithatë kur qeveria e re e PPSH-së nuk ishte në gjendje të qeveriste vendin pas shpërthimit të grevave të përgjithshme të organizuara nga bashkimi i sindikatave jo-komuniste, PD-ja ra dakort të mernte pjesë në një qeveri koalicioni të mandatuar për të zgjidhur problemet dhe të përgatitej për zgjedhje të reja. Në dhjetor të vitit 1991 z. Berisha dhe PD-ja, të shqetësuar nga përkeqësimi i ekonomisë, mosfunksionimi i ligjit dhe rregullit dhe raportet për korrupsion zyrtar, u tërhoqën nga koalicioni qeverisës dhe kërkuan zgjedhje të reja. Zgjedhjet parlamentare të marsit të vitit 1992



rezultuan në një ndryshim dramatik të rezultateve të vitit të mëparshëm, ku Partia Demokratike fitoi 62% të votave popullore dhe 92 nga 140 vende në Kuvendin Popullor. Pas dorëheqjes së Presidentit Alia, Kuvendi Popullor i dominuar nga PD-ja, me 8 prill 1992, zgjodhi Sali Berishën si Presidentin e parë të shtetit post-komunist. Pas zgjedhjes së tij si President i Republikës së Shqipërisë, z. Sali Berisha dhe qeveria e re demokratike u përfshinë në një gamë të gjerë reformash politike, ekonomike, institucionale, legjislative dhe reformash të gjithanshme. Kështu, privatizimi i plotë i tokës dhe banesave, si dhe i kompanive shtetërore të vogla dhe të mesme u krye gjatë periudhës '92-'96; çmimet dhe kursi i këmbimit u liberalizuan plotësisht dhe Shqipëria ndryshoi nga një vend me shkallë inflacioni 3 shifror dhe një rënie të rritjes ekonomike me -20%, në një vend me shkallë inflacioni një shifror dhe me një mesatare të rritjes ekonomike prej 9% në vitin 1992 dhe ku në '93 -'96, 75% e GDP-së arrihej nga sektori privat. Shqipëria u hap ndaj perëndimit; ajo u bë anëtare e Këshillit të Europës në vitin 1995; nënshkroi Marrëshveshjen për Paqe dhe Partneritet në vitin 1993 dhe vendosi bashkëpunim të ngushtë me vendet e BE-së dhe SHBA-në. Të gjitha ligjet e diktaturës komuniste u zëvendësuan me ligje të reja të standarteve europiane dhe u krijuan një seri institucionesh, të cilat nuk ekzistonin më parë, si Gjykata Kushtetuese dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Në vitin '97, menjëherë pas revoltave të organizuara nga ish-komunistët, të cilët përfituan nga rënia e skemave mashtruese piramidale, z. Berisha dha dorëheqjen nga Zyra e Presidentit, dhe PD-ja kaloi në parti opozitare në zgjedhjet parlamentare. Më pas ai u zgjodh Kryetar i Partisë Demokratike dhe këtë pozicion e mban nga viti '97 deri më sot, i rizgjedhur në prill 2005. Z. Berisha drejtoi koalicionin e partive të qëndrës së djathtë në zgjedhjet e përgjithshme politike të mbajtura në pesë raunde në periudhën qershor-gusht 2001. Megjithëse misioni vëzhgues ndërkombëtar OSBE/ODIHR i quajti këto zgjedhje të manipuluar, koalicioni fitoi 37% të votave. **Me 3 korrik 2005**, Sali Berisha drejtoi koalicionin e pesë partive të qëndrës së djathtë, të cilat fituan një mazhorancë prej 74 deputetësh nga 140 gjithsej në Kuvend. Ai u emërua Kryeministër i Shqipërisë me 8 shtator 2005, më një shumicë prej 81 votash në parlament. Ai është i martuar me znj. Liri Berisha, e cila është pediatre dhe kanë dy fëmijë, një vajzë, Argitën, dhe një djalë, Shkëlzenin. Ai zotëron mirë gjuhën angleze, frënge, italiane dhe ruse.



## BIBERAJ, Aleksandër



Datëlindja: 15.1967

Vendlindja: Bajram

Curri

Zona Nr.: 10

Qarku: Kukës

*Adresa:*

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"*

*Tiranë*

*Tel.: 00355 4 234612*

**Grupi Parlamentar: PD**

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, anëtar.

Komisioni për Integrimin Europian (anëtar zëvendësues).

Komisioni Hetimor "Për hetimin e procedurave të tenderimit të rrugës Durrës-Morinë" - Kryetar.

**Edukimi:** 2001-2005: Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Departamenti i Menaxhimit - Mbrojtje titulli Doktor Shkencash; Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik. 1998-2000: Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik; Universiteti i Nebraskës - USA.

MBA-Master of Business Administration.

1985-1990: Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë, Dega Elektronikë.

Kualifikime: 2003 (maj) - Angli: Interchange Group Ltd. - Teknologji Informatiioni IT

1997(dhjetor) - USA: CTR Group Ltd - Projektet me Fibra Optike - Project Oxygen.

1997 (janar-shkurt) - Japoni: Qeveria japoneze-JICA - Menaxhimi i Biznesit në Telekomunikacion.

1996(nëntor-dhjetor) - Francë: France Telecom - Teleaktiviteti dhe Teknologjitë e Reja.

1995(tetor) - Poloni: Adan Smith Institute - Telekomunikacioni në Europën Juglindore.

1995(gusht-tetor) - Suedi: Qeveria Suedeze-SIDA - Menaxhimi Operativ në Telekomunikacion.

1995(qershor) - Spanjë: AT&T - Projektet me Fibra Optike - ADRIA  
1995(mars) - Austri: EBRD-Joint Vienna Institute - Menaxhimi i Burimeve Njerëzore. 1994(nëntor-dhjetor)- Austri: EBRD-Joint Vienna Institute - Menaxhimi Strategjik dhe Lidhshipi.

1994(korrik) - Belgjikë: KE - Menaxhimi i Projekteve Cross-Border.

1994(qershor) - Hungari: KE - Reformat në Europën Juglindore.

**Karriera politike:**

Dhjetor 1990: pjesëmarrës në Lëvizjen studentore dhe krijimin e Partisë Demokratike; 1991: anëtar i komisionit nismëtar, themelues i PD-së, dega Tropojë; 1991-1992: anëtar i kryesisë së PD-së, dega Tropojë dhe kryetar i FRPDSH-së së Tropojës; 1992: anëtar i Këshillit Bashkiak, Bajram Curri; 1992-1997: Forumi Rinor i PDSH-së, anëtar i Këshillit Kombëtar, anëtar i Kryesisë (1994-1996); nënkryetar i FRPDSH-së; 2002 e vazhdim: PDSH - dega Tiranë, sekretar i Marrëdhënieve me Publikun; 1997-2005: PDSH - dega Tiranë, anëtar i Kryesisë; 2005 (prill): Kuvendi i VIII-të Kombëtar i PD-së, anëtar i Këshillit Kombëtar, anëtar i Kryesisë së PDSH-së.

Maj 2006 - Nëntor 2006: anëtar i Komisionit Hetimor për hetimin e tregut monopol të telefonisë celulare dhe përgatitjen e rekomandimeve për liberalizimin e këtij tregu në Shqipëri.



### Karriera jopolitike:

2003-2005: Albanian Fiber Backbone - AFB, Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve drejtues Projekti; 2002-2003: Albtelcom Sh.a.- specialist në Departamentin e Zbatimit të Projekteve; 2001-2002: Albtelcom Sh.a.- specialist në Departamentin e Zhvillimit; 1997-2001: Albtelcom Sh.a.- specialist në Departamentin e Marketingut; 1994-1997: Telekom Shqiptar: Zv/drejtor i Përgjithshëm, anëtar i Këshillit Drejtues Kryetar i Bordit Teknik; 1993-1994: inxhinier pranë Radiotelevizionit Shqiptar; 1992-1993: Telekom Shqiptar, Filiali Tropojë Drejtor; 1992: Telekom Shqiptar, Filiali Tropojë K/ inxhinier; 1991: Ndërmarrja PTT, Tropojë inxhinier; 1994-1997: ADRIA 1 - Projekt Ndërkombëtar me Fibra Optike - Gjermani- Kroaci-Shqipëri-Greqi: anëtar i Bordit Drejtues, TBL-Trans Balcan Line - Projekt Ndërkombëtar me Fibra Optike - Itali-Shqipëri-Maqedoni-Bullgari-Turqi: anëtar i Bordit Drejtues, Komuniteti European: përfaqësues i telekomit Shqiptar. - Njohje të gjerë të tregut të telekomunikacioneve (vendas dhe të huaj) ku përfshihet kuadri ligjor, rregullues dhe operues. - Njohuri të gjera në fushën ekonomike dhe në drejtimin ekonomik të kompanive. - Eksperiencë e gjerë në menaxhim ku përfshihet menaxhimi i projekteve, reformimi dhe menaxhimi i kompanive shtetërore nacionale. - Eksperiencë e gjerë në marrëdhëniet publike dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Tituj: Doktor i Shkencave; MBA

## BISHA, Besnik



Grupi Parlamentar: PR

Veprimtaria parlamentare aktuale:

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, sekretar.  
Komisioni për Politikën e Jashtme (anëtar zëvendësues).

Edukimi: Instituti i Lartë i Arteve - Specializuar për Regji Filmi.

Karriera politike: Deputet

Datëlindja: 9.8.1958

Vendlindja: Tiranë

Zona Nr.:

Lista shumemërore

Adresa:

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"

Tiranë

Tel.: 00355 4 232602





## BLUSHI, Ben



Datëlindja: 1.1.1969  
Vendlindja: Tiranë  
Zona Nr.: 8o  
Qarku: Korçë

Adresa:  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228356

**Grupi Parlamentar:** PSSH

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti Filologjik, Dega Gjuhë-Letërsi.

**Karriera politike:**

2001-2002: ministër i Arsimit dhe Shkencës; 2002-2005 (shtator): ministër i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit; 2001: Prefekt i Qarkut Korçë; 1997-1999: zëdhënës-këshilltar i Kryetarit të Këshillit të Ministrave; 1999-2000: Zv/ministër i Punëve të Jashtme.

**Karriera jopolitike:**

1991-1997: gazetar në "Koha Jonë", Deutsche Welle Independent; 1995-1996: Fondacioni Soros.

## BODE, Ridvan



Datëlindja: 26.6.1959  
Vendlindja: Korçë  
Zona Nr.: 8i  
Qarku: Korçë

Adresa:  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 232602

**Grupi Parlamentar:** PD

**Funksioni aktual:** Ministër i Financave.

**Edukimi:** UB Tiranë, diplomuar "Financier i Lartë".

Studime pasuniversitare:

1992-1993: Montpellier, Francë, "Diplome de specialisation Post Universitaire" (DSPU), me vlerësimin "Cum Maxima Laude"; 1992-1995: përfundon ciklin e thelluar të studimeve pasuniversitare në Montpellier, Francë dhe fiton titullin "Master of Science", në opsionin "Kërkim shkencor" me vlerësimin "Cum Maxima Laude".

**Karriera politike:** 1996-1997: ministër i Financave; 1996-1997: deputet në Kuvendin e Shqipërisë; 1997-1999: Sekretar i Përgjithshëm i PDSH-së, anëtar i Kryesisë dhe anëtar i Këshillit Kombëtar të PDSH-së; 1999-2001: Sekretar i Përgjithshëm i PDSH-së, anëtar i Kryesisë dhe anëtar i Këshillit Kombëtar të PDSH-së; 2001-2005: Sekretar i Përgjithshëm i PDSH-së, anëtar i Kryesisë dhe anëtar i Këshillit Kombëtar të PDSH-së; 2005 e vazhdim: Sekretar i Përgjithshëm i PDSH-së, anëtar i Kryesisë dhe anëtar i Këshillit Kombëtar të PDSH-së; 2001-2005 deputet në Kuvendin e Shqipërisë; 2005-deputet në Kuvendin e Shqipërisë.

**Karriera jopolitike:** 1983-1990: Shef i degës së financës Prrenjas, Librazhd; 1991-1995: pedagog i Analizës Financiare në UB të Tiranës; 1995-1996: Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Ministria e Financave; 1996-1997: ministër i Financave; 2002 e vazhdim: bashkëpunor e lektor i jashtëm në Fakultetin Ekonomik, UT.

**Tituj:** Master of Science; Diplome de Specialisation Post Universitaire.



## BRAÇE, Erion



Datëlindja: 2.4.1972  
Vendlindja: Tiranë  
Zona Nr.: 75  
Qarku: Berat

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234612

**Grupi Parlamentar:** PSSH - Nënkryetar

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, anëtar.

Komisioni Hetimor "Për hetimin e shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit në dispozicion të ministrive, institucioneve kryesore të varësisë dhe ndërmarrjeve publike nëpërmjet prokurimeve publike për periudhën 2001 e në vijim" - Kryetar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, dega Financë.

**Karriera politike:**

1994: Anëtar i Komitetit të Përgjithshëm Drejtues të PS-së; Zv.kryetar i FRESSH-it; 1996-1997: Deputet në Legjislaturën e XIV të Kuvendit Popullor; 1997-2001: Deputet në Legjislaturën e XV të Kuvendit Popullor dhe anëtar i Komisionit për Ekonominë, Financën dhe Privatizimin; 2001-2005: Deputet në Legjislaturën e XVI të Kuvendit të Shqipërisë; Maj 2006 - Korrik 2006: Anëtar i Komisionit Hetimor për Çështjen e Prokurorit të Përgjithshëm.

**Karriera jopolitike:**

1993-1997: Gazetar në gazetën "Zëri i Popullit"; 1998-2007: Kryeredaktor i gazetës "Zëri i Popullit".

## BREGU, Majlinda



Datëlindja: 19.5.1974  
Vendlindja: Tiranë  
Zona Nr.: 39  
Qarku: Tiranë

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë

**Grupi Parlamentar:** PD

**Funksioni aktual:**

Ministre e Integritimit.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Dega Punë Sociale - 1996; studime të thelluara në UT, Fakulteti i Shkencave Sociale, departamenti i Punës Sociale 2001-2003; studime për titullin PHD-Doktor në Fakultetin e Sociologjisë të Universitetit "Carlo Bo" të Urbino, Itali

Kurse të shumta trajnimi lidhur me Politikat Sociale dhe Studimet Gjinore.

**Karriera politike:**

Shtator 2005 - Mars 2007: Sekretare e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

**Karriera jopolitike:**

1996 e vazhdim: pedagoge pranë Departamentit të Punës Sociale në Fakultetin e Shkencave Sociale, UT; 1992-2005: eksperiencia të ndryshme pune pranë TVSH, TV Klan, anëtare e grupit të punës të TV gjerman ARD për përgatitjen e ciklit televiziv "Me sytë e grave", eksperiencia të shumta pune në Projekte të ndryshme; relatore në shumë Konferenca Kombëtare dhe Ndërkombëtare.

**Tituj:** Dr. në Shkencat Sociale.



### Publikime:

1998: Anëtare e grupit hartues të: Raporti i Zhvillimit njerëzor (HDR), botim i PNUD-it; 1999: Anëtare e grupit kërkimor për realizimin e Analizës Cilësore të programit të BBC-së “Rruga me Pisha”; 2000: Redaktore e tekstit “Udhërrefyes mbi praktiken e Punës Sociale”, Botuar nga CARE-International. Botim për studentët kosovarë; 2003: Përshtatje e tekstit “Kërkimi cilësor për shkencat sociale.Hapat, fazat dhe detyrat”. Libër për studentë; 2003: Bashkautore e “Monitorimi i shtypit mbi dhunën në familje 2001-2002”, Botuar nga Qendra e Gruas; 2004: Redaktim dhe përshtatje të Librit: “Ne dhe prostitutat. Do të takohemi në mbretërine qiellore” të Don Oreste Benzi; 2004: Bashkautore e “Monitorimi i shtypit mbi dhunën në familje 2003”, botuar nga Qendra e Gruas; 2004: Probleme të medias në pasqyrimin e çështjeve sociale; 2005: Bashkautore e “Trajtesa juridike dhe Sociale për Mbrojtjen nga dhuna në Familje”; Artikuj: “Apokalipsi kulturor dhe pseudovlerat e moralit tonë” Bashkautoresi; “Prostitucioni i Seksualitetit”; “Gratë ... dhe gratë në vendimmarrje”; “Herën tjetër do të të vras”; “Përkatesia gjinore dhe politikat sociale”; “Për force zakoni...”; “Asistenca apo kultura e varfërisë”?

## BROKAJ, Sabit



Datëlindja: 7.1.1942  
Vendlindja: Vlorë  
Zona Nr.: Lista  
shumemërore

Adresa:  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi “Dëshmorët e  
Kombit”  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228356

**Grupi Parlamentar:** LSI&PDS

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin – Anëtar.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, anëtar.

Maj 2007-... : Anëtar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

Komisioni i Posaçëm për Integrimin në NATO, anëtar.

Komisioni hetimor “Mbi përgjimet e paligjshme të telefonave”, anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë.

**Karriera politike:**

1991 (shkurt-dhjetor): ministër i Shëndetësisë; 1997-1998: ministër i Mbrojtjes; 1998-2002: këshilltar i Presidentit të Republikës për çështjet e mbrojtjes; Nënkryetar i LSI-së.

**Karriera jopolitike:**

1969-1972: mjek ushtarak, Shijak; 1972-1982: mjek në Spitalin Ushtarak; 1982-1991: pedagog në Fakultetin e Mjekësisë, UT.

**Tituj:** Profesor Doktor

**Publikime:** 3 libra dhe shumë artikuj në periodikun shqiptar dhe të huaj.



## BUFI, Ylli



Datëlindja: 25.5.1948

Vendlindja: Tiranë

Zona Nr.: 69

Qarku: Fier

**Adresa:**

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë*

Tel.: 00355 4 234607

**Grupi Parlamentar:** PSSH

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Byroja e Kuvendit – Nënkryetar.

Këshilli për Legjislacionin – Anëtar.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin - Kryetar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, dega Kimi Industriale - 1972.

**Karriera politike:**

1997 (korrik) -1999 (tetor): ministër i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit;

1997 (mars-korrik): këshilltar politik i Kryeministrit të Qeverisë së Pajtitimit Kombëtar;

1991 (qershor-dhjetor): Kryeministër i Qeverisë së Stabilitetit; 1990-1991: ministër i Industrisë Ushqimore;

1983-1990: zv/ministër i Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore

2005 -2006: Nënkryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat; 2001-2005: kryetar i Komisionit Parlamentar të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit;

2001-2005: Kryetar i Delegacionit të Kuvendit të RSH-së në CEI; 2002-2005: anëtar i komisioneve të përkohshme parlamentare për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të OSBE-ODHIR-it për Reformën Zgjedhore dhe të shqyrtimit të projektligjit për Kthimin e pronave ish-pronarëve; 1992-1996: kryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar të Industrisë, Transportit dhe Tregtisë.

**Karriera jopolitike:**

1982-1983: Komiteti i Shkencës dhe Teknikës;

1976-1982: Ndërmarrja Ushqimore, Fier;

1972-1976: Uzina e Përpunimit të Naftës, Fier.

**Tituj:** Doktor i Shkencave.

**Publikime:** Artikuj në fushën parlamentare dhe profesionale

## BUMÇI, Aldo



Datëlindja: 11.6.1974

Vendlindja: Tiranë

Zona Nr.: 13

Qarku: Lezhë

**Grupi Parlamentar:** PD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Sekretariati për Procedurat dhe Votimet – Anëtar.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, anëtar.

Komisioni i Posaçëm për Integrimin në NATO, anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Bilkentit, Ankara - Turqi; Studime pasuniversitare, Magjistër në Marrëdhëniet Ndërkombëtare - 1997-1999. Universiteti i Mesdheut Lindor (Eastern Mediterranean University), Famagusta, Qipro Veriore - I diplomuar në Marrëdhëniet Ndërkombëtare - 1993-1997. Bursë kërkimore (Fellowship):



Instituti Shoqëria e Hapur (SOROS), International Policy Fellow për vitin 2001. Tema e kërkimit: “Marrëdhëniet ndërkufitare Shqipëri-Mali i Zi”.

**Kurse:** Çertifikatë për pjesëmarrjen në Kursin e avancuar për Zgjidhjen e Konfliktit dhe Ligjin Ndërkombëtar, organizuar nga Kolegji Kombëtar i Mbrojtjes i Suedisë - 2-19 prill 2000.

Çertifikatë për pjesëmarrjen në Shkollën e Verës për Shkencat Politike dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare, e organizuar në Tiranë nga Shoqata e Shkencave Politike Shqiptare, ku kam marrë pjesë në kurset: Demokratizimi, Politika Ndërkombëtare e Ballkanit, Qeverisja në Bashkimin Europian dhe Sfida e Zgjerimit - 9-30 korrik 2000.

**Karriera politike:** Deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë; anëtar i Këshillit Kombëtar dhe i Kryesisë së Partisë Demokratike; anëtar i Komitetit të Orientimit të Politikave; Shtator 2005 - Mars 2007: Ministër i Drejtësisë.

**Karriera jopolitike:** 1999-2005: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare; 2001-2004: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Shoqërore - pedagog i jashtëm.

**Publikime:** Kërkime dhe publikime:

Kam marrë pjesë si kërkues për Shqipërinë në projektin e titulluar “Mësimet e nxjerra nga politikat kundër korrupsionit”, iniciuar nga Qendra për Studimin e Politikave në Universitetin e Europës Qendrore, Budapest - 2003 (korrik-dhjetor);

Aldo Bumçi dhe Kol. Sandër Lleshi: “Qeverisja e mirë në marrëdhëniet civile—ushtarake”, në botimin e përgatitur nga Jan Trapans dhe Philip Fluri “Qeverisja dhe Reforma në Sektorin e Sigurisë dhe Mbrojtjes në Europën Juglindore” - Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura - Gjenevë 2003 (anglisht). Aldo Bumçi: “Perspektivat rajonale për një Kosovë të pavarur - Shqipërinë dhe Maqedoninë”, në botimin e përgatitur nga Florian Biber dhe Zhidas Daskalovski (eds.) “Të kuptuarit e Luftës në Kosovë”, Frank Cass 2003 (anglisht).

Aldo Bumçi: “Marrëdhëniet ndërkufitare ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi”, studim i bërë në kuadrin e bursës nga Programi i International Policy Fellowship i Institutit të Shoqërisë së Hapur (Soros) - Budapest, 2002.

Blendi Kajsio, Aldo Bumçi, Albert Rakipi: “Shqipëria: Një Shtet dhe Demokraci e Dobët” - Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, 2002. Aldo Bumçi: “Mali i Zi: Sfida e dyfishtë e Reformave të Brendshme dhe Statusit të Pacaktuar”, në botimin e përgatitur nga Pedrag Jurekoviç, (ed.) Ndërtimi i Stabilitetit në Shtetet e Dobëta: Ballkani Perëndimor - Konsortiumi i Akademive të Mbrojtjes - Vienë, 2002 (anglisht). Aldo Bumçi: “Maqedonia dhe shqiptaërt: Kufinj të politikës etnike”, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare - Dhjetor, 2001. Aldo Bumçi: “Shqipëria në kërkim të sigurisë” në botimin e përgatitur nga Gustav E. Gustenau (ed.), “Pas dhjetë vitesh: Sfidat e demokratizimit dhe sigurisë në Europën Juglindore” - Konsortiumi i Akademive të Mbrojtjes - Vienë, 2001 (anglisht).

---

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228248



## BUSHATI, Astrit



Datëlindja: 21.8.1962

Vendlindja: Shkodër

Zona Nr.: 2

Qarku: Shkodër

Adresa:

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234612

**Grupi Parlamentar:** PD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin – Anëtar.

Këshilli për Legjislacionin – Anëtar.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, anëtar.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare (anëtar zëvendësues).

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti Juridik - 1996; Kolegji i Mbrojtjes në Akademinë e Mbrojtjes -2002; Fakulteti Ekonomik, Master në Administrim Publik - 2003 e vazhdim.

**Karriera politike:**

1991: anëtar i PD-së; 1996-2001: anëtar i Këshillit Bashkiak, Shkodër; 1997-2001: kryetar i PD-së, Shkodër; 1998-2001: anëtar i Këshillit Kombëtar dhe Kryesisë së PD-së; 2005 e vazhdim: kryetar i PD-së, Shkodër.

**Karriera jopolitike:**

1992-1993: sekretar i Kryetarit të Komitetit ekzekutiv, Shkodër; 1993-1997: shef i Zyrës Juridike dhe Nënkryetar i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë, Shkodër; 1997 e vazhdim: avokat.

## BYLYKBASHI, Aurel



Datëlindja: 22.12.1966

Vendlindja:

Zona Nr.: 54

Qarku: Elbasan

Adresa:

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 232602

**Grupi Parlamentar:** Qendra Demokrate

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, anëtar.

**Edukimi:** Universiteti Politeknik i Tiranës, dega Inxhinieri Mekanike - 1990-1995; specializim për Diplomën e Inxhinierisë në Universitetin Politeknik të Barit - 1995; Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, dega Juridik - 2004.

**Karriera politike:**

1990: pjesëmarrës në Lëvizjen Studentore të Dhjetorit '90; 1991: pjesëmarrës i Grevës së Urisë së Studentëve; pas diplomimit jep kontributin e tij në jetën politike të qytetit të Elbasanit, në funksionet e Sekretarit dhe aktualisht në atë të Kryetarit të degës së Partisë Demokratike Elbasan; 1999 e vazhdim: anëtar i Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike Shqiptare; 2005: deputet i PD-së; Shtator 2005 - Prill 2006: anëtar i Komisionit për Integrimin Europian.

**Karriera jopolitike:**

1997-1999: Kryetar Rajoni në Bashkinë e Elbasanit; 1997-2001: Sekretar i Degës së PD-së, Elbasan; 2001: Kryetar i Degës së PD-së, Elbasan; 2003: anëtar i Këshillit Bashkiak në Bashkinë e Elbasanit; 2003: anëtar i Këshillit të Qarkut, Elbasan.



## ÇAÇI, Albert



Datëlindja: 30.9.1957  
Vendlindja: 66  
Qarku: Fier

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234610

**Grupi Parlamentar:** PSSH

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin – Anëtar.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë - Nënkyetar.

Komisioni Hetimor "Për hetimin e objektit dhe procedurave të kontratës së privatizimit të Albtelekomit për periudhën 2001 e në vijim", anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë.

**Karriera politike:**

1999-2001: zëvendësministër në Ministrinë e Punëve Publike; 2001-2005: deputet në Legjislaturën XVI.

**Karriera jopolitike:**

1981-1984: ekonomist, Shpim-Kërkim Naftë Patos; 1984-1988: kryetar i degës së planifikimit në SH.K. Naftës, Patos; 1988-1991: drejtor ekonomik DPN6 (Albpetrol), Patos; 1991-1992: këshilltar i ministrit për naftën; 1992-1997: aktivitet privat; 1997-1999: drejtor i Drejtorisë Ekonomike në Ministrinë e Drejtësisë; 1999-2001: zëvendësministër në Ministrinë e Punëve Publike.

## CARA, Engjëll



Datëlindja: 20.7.1965  
Vendlindja: Kavajë  
Zona Nr.: 49 -  
Kavajë  
Qarku: Tiranë

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 232575

**Grupi Parlamentar:** PD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Integrimin Europian, anëtar.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë (anëtar zëvendësues).

**Edukimi:** Arsimi i lartë.

**Karriera politike:**

2001 e vazhdim: kryetar i PD-së, Kavajë; 1997-2001: anëtar i Kryesisë së degës së PD-së, Kavajë; 2001 e vazhdim: anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së; 2000-2005: kryetar i Këshillit Bashkiak, Kavajë; 1996-2000: anëtar i Këshillit Bashkiak.

**Karriera jopolitike:**

1987-1991: specialist Blegtori; 1991-1992: Filiali i përmirësimit racor; 1992-1997: Drejtor i Bujqësisë, Kavajë; 1997-2001: i papunë.



## CEKA, Neritan



Datëlindja: 11.2.1941  
Vendlindja: Tiranë  
Zona Nr.: Lista  
shumëmërore

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel/Fax: 00355 4  
228526

**Grupi Parlamentar:** QLD - Kryetar

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Konferenca e Kryetarëve - Anëtar (Kryetar i Grupit Parlamentar "Qendra Liberal Demokratë"). Këshilli për Legjislacionin - Anëtar Komisioni për Politikën e Jashtme, anëtar. Maj 2007-... : Anëtar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori-Filogji.

**Karriera politike:** 1991: Kryetar i Grupit Parlamentar të PD-së; 1991: Nënkryetar i PD-së; 1992-: President i Aleancës Demokratike; 1997-1998: Ministër i Brendshëm; 1998-2005: Kryetar i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare. Maj 2006 - Nëntor 2006: Kryetar i Komisionit Hetimor për hetimin e tregut monopol të telefonisë celulare dhe përgatitjen e rekomandimeve për liberalizimin e këtij tregu në Shqipëri.

**Karriera jopolitike:** 1985-1990: Shef i Departamentit të Arkitekturës në Institutin Arkeologjik; 1990-1993: Drejtor i Institutit Arkeologjik.

**Tituj:** Profesor

**Publikime:** Qyteti ilir pranë Selcës së Poshtme (1985); Arkeologjia: Greqia, Roma, Iliria (1994); Ilirët (2001); Apollonia e Ilirisë (1982); Butrinti (2001); Bglise (2004).

## ÇELA, Blerim



Datëlindja: 28.4.1944  
Vendlindja: Korçë  
Zona Nr.: 62 -  
Lushnjë  
Qarku: Fier

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234612

**Grupi Parlamentar:** PD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat - Sekretar.

Komisioni Hetimor "Për zbatimin e ligjit të koncesioneve, dhënien me koncesion të objekteve të ndryshme në pronësi shtetërore, kushtet e dhënies së këtyre kontratave për periudhën 2001 e në vijim dhe procedurat për fillimin e punimeve për ndërtimin e TEC-it të Vlorës", anëtar.

**Edukimi:** Shkolla e Lartë për Ekonomi, Tiranë - 1969.

**Karriera politike:** 1991-1996: anëtar i Kryesisë së PD-së; 1991 e vazhdim anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së; 1991-1992, 1992-1996, 1996-1997: deputet i PD-së; 1992-1997: Kryetar i KLSH.

**Karriera jopolitike:** 1970-1972: Shef llogarie -Kantieri i Bonifikimit, Thumanë; 1972-1981: K/Degës Financës -Fabrika Çimentos, Fushë Krujë; 1981-1987: K/Degës së Financës në Ndërmarrjen e Ndërtimit të H/Centraleve Koman; 1987-1989: Inspektor finance në ministrinë e Ndërtimit; 1989-1992: Drejtor i Financë-Kontrollit në ministrinë e Ndërtimit; 1997-2005: Drejtor i Departamentit të Financave PDSH.

**Tituj:** Doktor i Shkencave Ekonomike

**Publikime:** 1996 - "Kontrolli Publik në Demokraci"; 2001 - "Shqiptarët ndër shekuj"; Artikuj e kumtesa në shtypin periodik shqiptar dhe të huaj.





## ÇIPA, Stefan



Datëlindja: 20.1.1959  
Vendlindja: Sarandë  
Zona Nr.: 100 -  
Sarandë  
Qarku: Vlorë

**Adresa:**

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234612

**Grupi Parlamentar:** PSSH

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, anëtar.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare (anëtar zëvendësues).

Komisioni hetimor "Mbi përgjimet e paligjshme të telefonave" -  
Nënkryetar.

**Edukimi:** Instituti i Lartë Bujqësor, Fakulteti i Ekonomisë Agrare,  
dega Plan.

**Karriera politike:**

1991: Anëtar i Kryesisë së PS-së, Sarandë; 1991-1992: Kryetar i  
Komitetit Ekzekutiv Pluralist, Sarandë; 2002 (shkurt)-2002 (korrik):  
Ministër i Rendit Publik.

**Karriera jopolitike:**

1983-1986: Ekonomist dhe Kryetar degës së Planit në Kooperativën  
Bujqësore, Kukës; 1987-1988: Kryetar i furnizimit dhe shpërndarjes  
në Ndërmarrjen e Grumbullimit të Drithit, Sarandë; 1988-1991:  
Drejtor i Ndërmarrjes së Grumbullimit të Drithit, Sarandë; 1992-  
1993: Kryetar dege në Ndërmarrjen e Grumbullimit të Drithit,  
Sarandë.

## ÇOBAJ, Ramiz



Datëlindja: 8.4.1961  
Vendlindja: Shkodër  
Zona Nr.: 3  
Qarku: Shkodër

**Adresa:**

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228248

**Grupi Parlamentar:** PAA

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Byroja e Kuvendit - Sekretar për Buxhetin.

Sekretariati për Buxhetin - Sekretar.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat  
e Njeriut, anëtar.

**Edukimi:** Fakulteti Ekonomik; Fakulteti i Drejtësisë; Akademia e  
Rendit.

**Karriera politike:**

2005: deputet i PD-së.

Maj 2006 - Nëntor 2006: anëtar i Komisionit Hetimor për hetimin  
e tregut monopol të telefonisë celulare dhe përgatitjen e  
rekomandimeve për liberalizimin e këtij tregu në Shqipëri.

**Karriera jopolitike:**

1985-1990: Ekonomist; 1990-2000: Oficer Policie (Oficer drejtimi,  
Shef sektori, Kryetar Dege, Drejtor i Drejtorisë së Krimeve); 2002-  
2005: Avokat; 2001-2005: Jurist.



## ÇULI, Diana



Datëlindja: 13.4.1951

Vendlindja: Tiranë

Zona Nr.:

Lista shumemërore

Adresa:

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"*

Tiranë

Tel.: 00355 4 232602

**Grupi Parlamentar:** PSD - Sekretare

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Byroja e Kuvendit - Sekretare për Marrëdhëniet me Jashtë.

Sekretariati për Marrëdhëniet me Jashtë – Sekretare.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, anëtare.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

**Karriera politike:** Karriera politike ka qenë e lidhur indirekt me hartimin e ligjeve të ndryshme, oponentca etj.

**Karriera jopolitike:**

1973-1990: Gazeta "Drita" dhe Revista "Les lettres albanaises"; 1990-2000: presidente e Forumit të Pavaruar të Gruas; 1993-1998: presidente e Forumit të OJQ-ve Shqiptare; 2004-2005: përfaqësuese e Shqipërisë në Komisionin e Kulturës në KE; 1995-2005: anëtare e Bordit Interballkanik të Grave; anëtare e Këshillit Mesdhetar të Grave.

**Tituj:** 7 romane, 2 vëllime me tregime, drama, skenarë filmi, artikuj, studime letrare brenda dhe jashtë vendit.

## DADE, Arta



Datëlindja: 15.3.1953

Vendlindja: Tiranë

Zona Nr.: 65

Qarku: Fier

Adresa:

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"*

Tiranë

Tel/Fax: 00355 4  
228526

**Grupi Parlamentar:** PSSH

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Politikën e Jashtme - Nënkryetare.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Dega Gjuhë Angleze - 1972-1975.

**Karriera politike:** 1991: Anëtare e PS-së; 1992: Anëtare e Kryesisë së PS-së; 1993: Anëtare e Forumit të Grave të Majta Europiane; 1996: Kandidate e PS-së për deputete; 1997-2001: Deputete në Legjislaturën e XV të Kuvendit të Shqipërisë; 1997 (korrik) - 1998 (prill): Ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve; Zv.Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare; anëtare e Komisionit të Posaçëm për Paktin e Stabilitetit; anëtare e APF-së (Asambleja Parlamentare e Frankofonisë); zëvendësuese në delegacionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës; 2001 (shtator) - 2002 (korrik): Ministre e Punëve të Jashtme; 1998-2001: Zv.kryetare e Komisionit Parlamentar të Politikës së Jashtme të Kuvendit të Shqipërisë; 1998: Sekretare Ndërkombëtare e PS-së (rizgjedhur disa herë).

**Karriera jopolitike:**

1975-1985: mësuese në Shkollën e Mesme të Gjuhëve të Huaja "Asim Vokshi", Tiranë; 1985-1997: pedagoge në Universitetin e Tiranës, Departamenti i Gjuhës Angleze. **Publikime:** utore e një sërë artikujsh me karakter politik, shoqëror dhe shkencor.



## DAJÇI, Pal



Datëlindja: 12.1.1962  
Vendlindja: Mamurras  
Zona Nr.: 17- Kurbin  
Qarku: Lezhë

Adresa:  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228248

**Grupi Parlamentar:** PD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, anëtar.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare (anëtar zëvendësues).

Komisioni Hetimor "Për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, z. Theodori Sollaku", anëtar.

**Edukimi:** Akademia e Sporteve "Vojo Kushi", Tiranë; Fakulteti Juridik, Shkodër.

**Karriera politike:**

Anëtar e drejtues i PD-së që në themelimin e saj; 1991-1992: Kryetar i Këshillit Pluralist të Bashkisë, Mamurras; 1992-1994: drejtues i kulturës dhe sporteve në Këshillin e Rrethit, Kurbin; 1994-1997: drejtues (sekretar) i PD-së, Kurbin; 1997 e vazhdim: deputet.

Maj 2006 - Tetor 2006: anëtar i Komisionit Hetimor për Hetimin e Shkarkimeve në Administratë.

**Karriera jopolitike:**

1985-1991: Arsimitar në Shkollën e Mesme, Laç.

## DALIPI, Alfred



Datëlindja: 6.10.1970  
Vendlindja: Ersekë  
Zona Nr.: 88  
Qarku: Korçë

Adresa:  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 232602

**Grupi Parlamentar:** PSSH

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, anëtar.

Maj 2007-... : Anëtar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore. Komisioni Hetimor "Për hetimin e procedurave të tenderimit të rrugës Durrës-Morinë", anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, dega Italisht - 1993; Universiteti i Shkodrës, Fakulteti i Drejtësisë - 2003.

Formime të pjesshme: Administrim-Menaxhim, Francë - 1994-1995; Administrim publik, Universiteti i Barit - 2000-2001; Transformim i Ndërmarrjeve Shtetërore, Universiteti i Leçes - 2002-2003.


Trajnime mbi gazetarinë dhe menaxhimin në ShBA, Itali, Francë, Angli, Danimarkë, Gjermani.

**Karriera jopolitike:** 1992-1994: redaktor përgjegjës pranë gazetës "24 Orë"; 1994-1998: gazetar pranë gazetës "Zëri i Popullit"; 1999-2000: zv/drejtor i Përgjithshëm i RTSH-së; 2000-2001: drejtor i Televizionit Shqiptar; 2001-2005: zv/drejtor i Përgjithshëm i RTSH-së; 1997-1998 dhe 1998-1999: anëtar dhe zv/kryetar i Këshillit Drejtues; 2005 e vazhdim: anëtar i Bordit të administrimit të RTSH.

**Publikime:** Bashkautor dhe botues në frengjisht, italisht dhe anglisht i enciklopedisë "Shqipëria, trashëgimi e vlerave europiane" (1999).



## DEDJA, Taulant



Datëlindja: 20.2.1965

Vendlindja: Tiranë

Zona Nr.: 53

Qarku: Elbasan

**Adresa:**

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"

Tiranë

Tel.: 00355 4 228248

**Grupi Parlamentar:** Deputet i pavarur

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, anëtar.

**Edukimi:** Universiteti Montesquieu-Bordeaux IV, Francë: Diplomë Ndërkombëtare: Menaxhimi Ekonomik (Niveli Cikli III/Master), tema e Diplomës "Menaxhimi i burimeve njerëzore në Bankën e Shqipërisë".

1991-1993: kurse të rregullta pranë Fakultetit të së Drejtës dhe Shkencave Ekonomike, Neuchatel, Zvicër.

1987-1989: provime pasuniversitare në Universitetin e Tiranës Akademia e Arteve, dega Violinë, Tiranë.

**Karriera politike:**

1994-1995: anëtar i KPD-së të FRESH-it.

Nga shtatori 1999: zëvendëskryetar dhe sekretar i Komisionit për pushtetin vendor pranë KPD-së së PS-së.

1997 (dhjetor) e vazhdim: anëtar i KPD-së të PSSH-së.

**Karriera jopolitike:**

1983-1987: Orkestra e Harqeve e Akademisë së Arteve të Bukura; 1987-1990: Orkestra Sinfonike e RTSH-së; 1990-1994: Orkestra Sinfonike dhe Orkestra e Dhomës Neuchatel, Zvicër; 1987-1994: Koncerte recitale si solist në Shqipëri, Portugali etj; 1995-1996: gazetar, kryeredaktor në gazetën "Populli Po" dhe reporter politik në gazetën e pavarur "Dita Informacion"; 1997 (maj-gusht): anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; 1997 (shtator) - 1998 (shtator): Drejtor i Përgjithshëm i Pushtetit Vendor; 1998 (qershor-shtator): përfaqësues i Plotfuqishëm i Këshillit të Ministrave në Qarkun e Kukësit për krizën kosovare; 1998 (tetor) - 1999 (nëntor): zëvendësministër i Pushtetit Vendor; 1999 (nëntor) - 2001 (korrik): Prefekt i Qarkut Tiranë; 1997 (nëntor) - 1999 (nëntor): anëtar i Këshillit Mbikqyrës i Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare; 1999 (janar) - 2000 (dhjetor): kryetar i grupit të ekspertëve për Reformën e Decentralizimit pranë Komitetit Kombëtar për Decentralizim; 2001 (janar-korrik): anëtar i Komitetit Ndërmnistor për Reformën e Decentralizimit; 1997 (shtator) - 2000 (dhjetor): përfaqësues i Republikës së Shqipërisë pranë Komitetit Drejtues për Demokracinë Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Europës; 2001-2005: deputet, zona zgjedhore 51 Elbasan; 2002 (shtator) - 2003 (dhjetor): anëtar i Delegacionit të Përhershëm të Kuvendit të Shqipërisë pranë Asamblesë Parlamentare të OSBE-së; 2001 (shtator) - 2002 (shtator) dhe 2003 (shtator) e vazhdim: anëtar i Delegacionit të Përhershëm të Kuvendit të Shqipërisë pranë Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës.

**Tituj:** Çmimi i Parë në Konkursin Kombëtar të Instrumentistëve të Rinj - 1979.

**Publikime:** "Niçja kundër Wagnerit" dhe "Durrenmat për Vaclav Havelin" (përkthime).



## DEMI, Leonard



Datëlindja: 8.8.1954  
Vendlindja: Delvinë  
Zona Nr.: 45  
Qarku: Tiranë

Adresa:  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228356

**Grupi Parlamentar:** PD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare - Kryetar.

**Edukimi:** Universiteti i Elbasanit, Dega Gjuhë-Letërsi - 1986; Studime për Politikë të Jashtme dhe Siguri Kombëtare në: Universiteti Hibru, Jeruzalem (Izrael) - 1992; Universiteti Xhorxh Uashington, Uashington D.C.-1993-1994; Nevëll Postgraduatej Skull, Monterey, Kaliforni (SHBA) - 2003.

**Karriera politike:**

2005 (prill): anëtar i Kryesisë, anëtar i Këshillit Kombëtar dhe Sekretar për Sigurinë - PD; 2003 (shtator): Sekretar për Sigurinë Kombëtare - PD; 1997 (shtator)-1999 (shtator): anëtar i Kryesisë dhe anëtar i Këshillit Kombëtar -PD; 1997 (shtator)-1999 (shtator): Sekretar për Marrëdhëniet Ndërkombëtare - PD.

**Karriera jopolitike:**

2003 e vazhdim: ligjërues në Universitetin e Tiranës, Shkolla e Studimeve Europiane; 2003: ligjërues, Akademia e Mbrojtjes Kursi i Shtabit të Përgjithshëm; 2003: ligjërues, Universiteti i Tiranës Fakulteti i Filologjisë; 2000-2001: ligjërues, Universiteti i Tiranës Fakulteti i Filologjisë; 1996-1997: Sekretar Shteti, Ministria e Mbrojtjes; 1992-1996: Drejtor Politik, Ministria e Punëve të Jashtme; 1989-1992: Punonjës Shkencor, Akademia e Shkencave; 1982-1989: Redaktor, Akademia e Shkencave; 1972-1982: shërbimi ushtarak dhe punëtor në Ndërmarrjen e Mjeteve Mësimore.

Tituj: Master për Sigurinë Kombëtare (Nevëll Postgraduatej Skull, Monterey, Kaliforni, SHBA - 2003); Doktor (Instituti i Gjuhës dhe Letërsisë; Akademia e Shkencave, Tiranë, 1994).

**Publikime:** "Shqipëria dhe diplomacia amerikane"; 2000; "Zgjerimi European dhe Integrimi i Ballkanit Perëndimor", Monterey-Kaliforni, 2003; Artikuj në shtypin periodik shqiptar dhe të huaj.

## DERVISHI, Besnik



Datëlindja: 4.8.1963  
Vendlindja: Tiranë  
Zona Nr.: 97  
Qarku: Vlorë

**Grupi Parlamentar:** PSSH

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Sekretariati për Procedurat dhe Votimet – Anëtar.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, anëtar.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin (anëtar zëvendësues).

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.

Kualifikime:

Nëntor 2001: Universiteti i Staffordshire, Angli.

Seminar kualifikimi: Metodrat krahasuese në administrimin publik.

Tetor 2001: Universiteti Staffordshire, Angli.



Seminar kualifikimi: Aktet ligjore dhe rregullatore në Bashkimin Europian. Shtator 2001: Universiteti Staffordshire, Angli.

Seminar kualifikimi: Menaxhimi i sektorit publik.

Dhjetor 1999: Instituti "TECNIC" Romë, Itali.

Kurs trainimi: "Zhvillimi, organizimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore". Tetor 1999: Komisioni Europian, Programi PHARE.

Kurs Kualifikimi ne Budapest, Hungari me temë: "Mosmarrëveshjet paskontraktuale FIDIC".

Qershor 1999: Kolegji Administrativ në Hydarabad, Indi.

"Procedurat e Prokurimit për Projektet e Ndhmës së Bankës Botërore". Maj 1995: Kurs kualifikimi në Firenze, Itali, "Agroturizmi".

Tetor 1992: Kualifikim pasuniversitar 9-mujor në R. C. Itali, "Për avokatinë e shtetit dhe formim profesional në punë" pranë zyrës lokale të Avokaturës së Shtetit.

**Karriera politike:** Maj 2006 - Tetor 2006: anëtar i Komisionit Hetimor për Hetimin e Shkarkimeve në Administratë.

1999-2003: Komisioni Qendror i Garancive Statutore, anëtar.

2003 e vazhdim: Anëtar i Komitetit të Përgjithshëm Drejtues të PS-së.

**Karriera jopolitike:** Korrik 2005: Deputet në Kuvendin e Shqipërisë; 2005 (janar-korrik): Kabineti i Kryeministrit, Këshilltar; 2004 (janar) - 2005(janar): Prefektura e Qarkut Tiranë, Prefekt; 2002 (korrik) - 2003 (dhjetor): Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministër; 2002 (mars-korrik): Ministria e Ekonomisë, Zëvendësministër; 2000 (shtator-mars): Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, Sekretar i Përgjithshëm; 2000 (janar-shtator): Ministria e Transportit, Drejtor i Drejtorisë së Integritimit dhe Çështjeve Juridike; 1999-2000: Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Licensave; 1992-1998: Avokat pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë; 1990-1991: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjyqtar; 1986-1989: Ministria e Puneve Publike, Jurist; Eksperiencia të tjera pune; 2002 (gusht) - 2003 (dhjetor): Nënkyetar i K.Rr.T.R.Sh; Nënkyetar i K.K.U., Anëtar i Bordit të F.Sh.Zh.; 2002 (prill-gusht): Kryetar i Këshillit Mbikqyrës të sh.a. "Taulantia"; 2002 (prill-gusht): Agjencia Shqiptare e Garancisë, anëtar i Bordit; 2000-2002: Instituti i Trainimit të Administratës Publike, anëtar i Bordit Këshillimor; 2001(janar-qershor): Universiteti Politeknik, Fakulteti i Inxhinierisë anëtar i Bordit të Këshillit Shkencor; 1999-2000: Enti Kombëtar i Banesave, anëtar i Këshillit Drejtues; 1988-1990: Gjykata e Apelit Tiranë, Nd Gjyqtar; Aktivitete shoqërore: Konsulent juridik i Fondacionit shqiptaro-danez "Kontribut për edukimin"; Aktivist i "Qendrës shqiptare për popullsi dhe zhvillim".

**Publikime:** Artikuj në shtypin e përditshëm dhe periodik me tema për fushën e së drejtës; Referime e kumtesa në seminare të ndryshme si "Raportet e gjyqësorit me Administratën", "Avokati i kompanisë", " Reforma në administratën publike, ecuria dhe problemet" etj.

**Adresa:**

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Tiranë

Tel.: 00355 4 228248



## DIVJAKA, Albert



Datëlindja: 12.4.1965

Vendlindja: Fier

Zona Nr.:

Lista shumemërore

Adresa:

Kuvendi i Shqipërisë

Bulevardi "Dëshmorët e

Kombit"

Tiranë

Tel.: 00355 4 232575

**Grupi Parlamentar:** PSD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Integrimin Europian, anëtar.

Komisioni Hetimor "Për zbatimin e ligjit të koncesioneve, dhënien me koncesion të objekteve të ndryshme në pronësi shtetërore, kushtet e dhënies së këtyre kontratave për periudhën 2001 e në vijim dhe procedurat për fillimin e punimeve për ndërtimin e TEC-it të Vlorës", anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, dega Industri Impiante - 1989.

**Karriera politike:**

1992-1997: anëtar i Kryesisë së PSD-së, dega Lushnjë; 1997-2000: nënkryetar i PSD-së, dega Lushnjë; 2000-2005: kryetar i degës së PSD-së Lushnjë dhe anëtar i Këshillit Kombëtar të PSD-së; 2003 e vazhdim: anëtar i Kryesisë së PSD-së.

**Karriera jopolitike:**

1989-1991: inxhinier mekanik në Nd/Shpim-Kërkim Gazi, Lushnjë; 1991-1992: drejtor i N.G.P. Drithit, Lushnjë; 1992-1997: drejtor i Fabrikës së Letrës, Lushnjë; 1997-1998: specialist në ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit; 1998-1999: administrator i sh.a. Fabrika e Letrës; 2000-2001: drejtor i MM Rrugë Nacionale Lushnjë.

## DOKLE, Namik



Datëlindja: 11.3.1946

Vendlindja: Durrës

Zona Nr.: 57

Qarku: Elbasan

Adresa:

Kuvendi i Shqipërisë

Bulevardi "Dëshmorët e

Kombit"

Tiranë

Tel/Fax: 00355 4

228526

**Grupi Parlamentar:** PSSH

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Politikën e Jashtme, anëtar.

**Edukimi:** Instituti i Lartë Bujqësor, Dega Ekonomi Agrare - 1965-1970; Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gazetarisë - 1968-1970.

**Karriera politike:**

1991: anëtar i Kryesisë së PS-së; 1992-1997: kryetar i Grupit Parlamentar të PS-së; 1996-1997: sekretar Organizativ i PS-së; 1992-1996: Nënkryetar i PS-së; 1997-2001: Nënkryetar i Kuvendit të Shqipërisë; 2001 (shtator)-2002 (prill): Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë; 1992-2000: përfaqësues i Kuvendit të Shqipërisë në Asamblenë Parlamentare të KE-së, Kryetar i Delegacionit Parlamentar në Asamblenë Parlamentare të KE-së; 1999-2000: Sekretar i Përgjithshëm i PS-së; 2004-2005 (shtator): Zëvendëskryeministër i Republikës së Shqipërisë.

**Karriera jopolitike:**

1970-1983: gazetar në Redaksinë e gazetës "Puna"; 1983-1989: Kryeredaktor i gazetës "Puna"; 1989-1990: Sekretar i Bashkimeve Profesionale; 1991: Kryeredaktor në gazetën "Zëri i Popullit".



## DOSHI, Tom



Datëlindja: 6.6.1966  
Vendlindja: Shkodër  
Zona Nr.: 7  
Qarku: Shkodër

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228248

**Grupi Parlamentar:** Demokristian  
**Veprimtaria parlamentare aktuale:**  
Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, anëtar.

**Edukimi:** Universiteti Shtetëror i Tetovës, dega Juridik – 2005.

**Karriera politike:**  
Deputet i PSSH. Shtator 2005 - Mars 2007: Anëtar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

**Karriera jopolitike:**  
1993-2005: Administrator i Përgjithshëm i firmës së Ndërtimit "Aldosch" sh.p.k.; 2000-2005: Drejtor i Përgjithshëm i Industrisë Farmaceutike "Profarma" sh.a. dhe Industrisë së Qumështit "Ajka".

## DULE, Vangjel



Datëlindja: 18.2.1968  
Vendlindja:  
Lista shumëmemërore

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel/Fax:  
00355 4 228526

**Grupi Parlamentar:** Qendra Demokrate - Kryetar  
**Veprimtaria parlamentare aktuale:**  
Konferenca e Kryetarëve - Anëtar (Kryetar i Grupit Parlamentar "Qendra Demokrate").  
Komisioni për Politikën e Jashtme, anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji, dega Gjuhë Angleze.

**Karriera politike:**  
1996-1997: Deputet në Legjislaturën e XIV të Kuvendit të Shqipërisë;  
1997-1998: Zv.kryetar i Bashkimit Demokrat të Minoritetit Etnik Grek "Omonia"; 1998-2002: Kryetar i "Omonia"-s; 2002 (shkurt): Kryetar i PBDNJ.

**Karriera jopolitike:**  
1991-1996: Përkthyes i gjuhës angleze dhe greke, gazetar i lire;  
1998-2001: Pedagog i jashtëm i gjuhësisë së përgjithshme në Universitetin "Eqerem Çabej", Gjirokastrë, dega anglisht.





## FARUKU, Albert



Datëlindja: 28.6.1971  
Vendlindja: Peshkopi  
Zona Nr.:

Lista shumëmerore

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234612

**Grupi Parlamentar:** PR - Sekretar

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Sekretariati për Buxhetin – Anëtar.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, anëtar.

Komisioni për Integrimin Europian (anëtar zëvendësues).

Komisioni Hetimor "Për hetimin e shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit në dispozicion të ministrive, institucioneve kryesore të varësisë dhe ndërmarrjeve publike nëpërmjet prokurimeve publike për periudhën 2001 e në vijim", anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik, specialiteti Marketing - 1993; Universiteti "Luigj Gurakuqi", Fakulteti Juridik - 2005.

Trajnime: Ekonomia e tregut dhe ecuria e biznesit në Shqipëri, zhvilluar nga Fakulteti Ekonomik dhe Banka Botërore në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë USA.

**Karriera jopolitike:**

1993-1997: Drejtoria e Doganës, specialist i regjimeve të përkohshme dhe i vlerës; 1998-2000: specialist pranë Agjencisë së Shërbimeve doganore Mirlin; 2001-2004: ekonomist kompanisë "Aurora".

## FINO, Bashkim



Datëlindja: 12.10.1962  
Vendlindja: Tiranë  
Zona Nr.: 78  
Qarku: Berat

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228248

**Grupi Parlamentar:** PSSH

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, anëtar. Komisioni Hetimor "Për zbatimin e ligjit të koncesioneve, dhënien me koncesion të objekteve të ndryshme në pronësi shtetërore, kushtet e dhënies së këtyre kontratave për periudhën 2001 e në vijim dhe procedurat për fillimin e punimeve për ndërtimin e TEC-it të Vlorës", anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, dega Financë - 1986; specializim për menaxhim të pushtetit vendor në SHBA, Itali, Greqi e Finlandë - 1996.

**Karriera politike:**

1993 e vazhdim: anëtar i KPD-së së PS-së; 1997 e vazhdim: anëtar i Kryesisë së PS-së; 1997 (mars-korrik): Kryeministër i Qeverisë së Pajtitimit Kombëtar; 1997-1998: Zv/kryeministër dhe ministër i Pushtetit Lokal; 1999-2001: ministër i Pushtetit Lokal; 2001-2002: ministër i Punëve Publike dhe Turizmit; 2004-2005 (shtator): ministër i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

**Karriera jopolitike:**

1987-1990: Qendra e Informatizimit Ekonomik, shef i Sektorit të Studimeve Ekonomike Gjirokastër; 1990-1992: drejtor i Qendrës së Informatizimit Ekonomik, Gjirokastër; 1992-1996: Kryetar i Bashkisë, Gjirokastër.

**Tituj:** Qytetar Nderi i Peorias (Illinois) dhe Losville (1996).



## GEGA, Alfred



Datëlindja: 29.3.1971

Vendlindja: Korçë

Zona Nr.:

Lista shumemërore

*Adresa:*

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234610*

**Grupi Parlamentar:** PR

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, anëtar.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare (anëtar zëvendësues).

Komisioni Hetimor "Për hetimin e objektit dhe procedurave të kontratës së privatizimit të Albtelekomit për periudhën 2001 e në vijim", anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, Mjekësi e Përgjithshme - 1989-1994; Specializim pasuniversitar (kirurgji Ortopedike) - 1996-2000.

**Karriera politike:**

2001 e vazhdim: anëtar i PR-së; nënkryetar i Forumit Rinor Republikan.

**Karriera jopolitike:**

1995-1996: mjek i përgjithshëm; 1996-2000: specializim pasuniversitar; mjek kirurg-ortoped në SUQU, Tiranë.

## GJANA, Jemin



Datëlindja: 5.5.1950

Vendlindja: Kukës

Zona Nr.: 11

Qarku: Kukës

*Adresa:*

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel/Fax:  
00355 4 228526*

**Grupi Parlamentar:** PD

**Funksioni aktual:**

Ministër i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

**Edukimi:** Fakulteti Ekonomi Agrare 1971-1975; Diplomuar në vitin 1985 (për motive biografie).

**Karriera politike:**

1991-1992: Sekretar i degës së PD-së, Pogradec; 1991 e vazhdim: anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së; 1997-2005 anëtar i Kryesisë së PD-së; 1999-2001: nënkryetar i PD-së; 2005 (prill) e vazhdim: sekretar Organizativ i PD-së; 1992-1993: Kryetar i Komisionit Parlamentar të Ekonomisë e Financave; 2001-2004: Kryetar i Komisionit Parlamentar të Bujqësisë dhe Ushqimit; 2002-2005 Bashkëkryetar i Komisionit Parlamentar Dypalësh për reformën Zgjedhore; 1992-2005: Kryetar në disa komisione të Posaçme dhe Hetimore Parlamentare; 1999-2001: Kryetar i Grupit Parlamentar të PD-së

**Karriera jopolitike:**

1975-1990: ekonomist në sferat e Bujqësisë dhe ndërtimit, Kukës e Pogradec



## GJERGJI, Sami



Datëlindja: 25.6.1954  
Vendlindja: Durrës  
Zona Nr.: 25  
Qarku: Durrës

Adresa:  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234607

**Grupi Parlamentar:** PD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, anëtar. Komisioni për Ekonominë dhe Financat (anëtar zëvendësues). Komisioni Hetimor "Për hetimin e shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit në dispozicion të ministrive, institucioneve kryesore të varësisë dhe ndërmarrjeve publike nëpërmjet prokurimeve publike për periudhën 2001 e në vijim", anëtar.

**Edukimi:** Universiteti Bujqësor i Tiranës, dega Zooteknik - 1977; Master në UBT. **Karriera politike:** Anëtar i Lëvizjes Demokratike që në fillimet e saj.

**Karriera jopolitike:**

1978-1985: kryespecialist në Seksionin e Bujqësisë, Fier; 1985-1988: kryespecialist në Seksionin e Bujqësisë, Durrës; 1988-1992: drejtor i Ndërmarrjes së Rritjes së Shpendëve, Durrës; 1992 e vazhdim: administrator dhe bashkëpronar i Kompanisë Floryhen; 1995 e vazhdim: president i Shoqatës së Agrobiznesit Shqiptar.

**Tituj:** Qytetar Nderi i Durrësit dhe i Manzës; Doktor i Shkencave Zooteknike. **Publikime:** "Porta Floryhen" Italisht-Anglisht; "Marrëdhëniet e publikut me biznesin"; qindra shkrime shkencore e publicistike, si dhe intervista në shtyp dhe në median audiovizive.

## GJINI, Frrok



Datëlindja: 6.9.1960  
Vendlindja: Shkodër  
Zona Nr.:  
Lista shumëmemërore

Adresa:  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234607

**Grupi Parlamentar:** Demokristian

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, anëtar.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare (anëtar zëvendësues).

**Edukimi:** Shkolla e Mesme "Agronomi Kulturë", Shkodër; Fakulteti i Drejtësisë, dega Juridik, Tetovë.

**Karriera politike:**

1990: pjesëmarrës në lëvizjen demokratike, Shkodër; 2000: themelues i Partisë Demokratë të Re; anëtar i Këshillit Kombëtar dhe Kryesisë së Partisë Demokratë.

**Karriera jopolitike:**

1990-1993: biznes privat, 1993-1995: forcat e Rendit, 1995-2000: drejtor i Shërbimit të Mjeteve Ujore, Shkodër; 2000-...: drejtues në një biznes privat.



## GJINUSHI, Skënder



Datëlindja: 24.12.1949

Vendlindja: Vlorë

Zona Nr.:

Lista shumemërore

Adresa:

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"

Tiranë

Tel/Fax: 00355 4

228526

**Grupi Parlamentar:** PSD - Kryetar

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Konferenca e Kryetarëve - Anëtar (Kryetar i Grupit Parlamentar të PSD-së). Komisioni për Politikën e Jashtme, anëtar.

Maj 2007-... : Anëtar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, dega Matematikë 5-vjeçare. Doktoraturë në Universitetin "Pierre et Marie Curie", Paris (Francë). Doktor i Shkencave, Universiteti i Tiranës.

**Karriera politike:**

1987-1991: Ministër i Arsimit; shkurt 1991: jep dorëheqjen; 1991 në vazhdim: Kryetar i Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, anëtare e I.S; deputet në Legjislaturat XI, XIII, XV e XVI; 1997-2001: Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë; 2001 (shtator)-2002 (korrik): Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale; Maj 2006 - Korrik 2006: Anëtar i Komisionit Hetimor për Çështjen e Prokurorit të Përgjithshëm.

**Karriera jopolitike:**

1973-1987: pedagog në Fakultetin e Shkencave të Natyrës; 1987-1990: ministër i Arsimit; 1986: Profesor; 1989: anëtar i Akademisë së Shkencave.

**Tituj:** Profesor Doktor në Matematikë.

**Publikime:** Ka botuar dhjetëra artikuj shkencorë, 12 tekste e monografia, 3 doktorata.

## GJONI, Petrit



Datëlindja: 12.2.1969

Vendlindja: Lezhë

Zona Nr.:

Lista shumemërore

Adresa:

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"

Tiranë

Tel.: 00355 4 234612

**Grupi Parlamentar:** PAA - Kryetar

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Byroja e Kuvendit - Sekretar për Statusin e Deputetit.

Sekretariati për Statusin e Deputetit – Sekretar.

Konferenca e Kryetarëve - Anëtar (Kryetar i Grupit Parlamentar të PAA). Komisioni për Ekonominë dhe Financat, anëtar.

Maj 2007-... : Anëtar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore. Komisioni hetimor "Mbi përgjimet e paligjshme të telefonave", anëtar.

**Edukimi:** Universiteti Buqësor, Fakulteti i Pyjeve, Kamëz.

**Karriera politike:**

Sekretar Organizativ i Partisë Agrare Ambientaliste. Shtator 2005 - Mars 2007: Anëtar i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

**Karriera jopolitike:**

2004(prill)-2005(maj): Prefekt i Qarkut Dibër; 1997-2004: drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Lezhë; 1994-1997: inxhinier në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Lezhë.



## HARASANI, Andis



Datëlindja: 9.8.1971

Vendlindja: Tiranë

Zona Nr.: 36

Qarku: Tiranë

*Adresa:*

*Kuvendi i Shqipërisë*

*Bulevardi "Dëshmorët e*

*Kombit"*

*Tiranë*

*Tel.: 00355 4 234612*

**Grupi Parlamentar:** PSSH

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, anëtar.

**Edukimi:** Fakulteti i Ekonomisë, Dega Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, Shqipëri.

Fakulteti i Jurisprudencës, Dega Juridik, Universiteti i Tiranës, Shqipëri.

ACIB - Associate Chartered Institute Of Bankers, Londër, Angli.

CFA - Chartered Financial Analyst.

Eksperienca: 8 vjet Bankier Tregtar.

Eksperienca: Shqipëri, Kosovë, Hungari, Itali, Greqi, Maqedoni, Rusi, Angli.

**Kualifikimet:** Bankier me eksperiencë tregtare e ndërkombëtare me manaxhim të gjërë, kredi, shqyrtim huaje, ristrukturim i borxhit, kapital ndërmarrjeje, dhe në aktivitetet tregtare dhe bankare me rrezik të lartë që përfshin korporatën.

Në pozicionet si tregtar-ndërkombëtar, aktivitete që përfshijnë: strukturimin e departamentit të kredisë dhe funksionet e ristrukturimit të borxhit; krijimin dhe zbatimin e politikave dhe procedurave të kredisë; shërben në departamente dhe komitetet e kredisë; kontrollon aktivitetet me vlerë; strukturon dhe negocion për lehtësira krediti me afatshkurtër dhe afatgjatë; inicion dhe kontrollon programe trajnimi për kredi dhe ristrukturim borxhi. Ka marrë pjesë në mënyrë aktive në grupet e manaxhimit për ndërtimin e katër bankave tregtare.

**Karriera politike:**

2005 (korrik) e në vazhdim: Deputet në Kuvendin e Shqipërisë.

**Karriera jopolitike:**

Tetor 2002 - Qershor 2005: Korporata Elektroenergetike Shqiptare: Drejtor i Përgjithshëm.

Maj 2001 - Shtator 2002: Këshilltar Financiar, Deloitte & Touche CE Pragë, Republika Çeke, në projektin e saj. Kosovo Business Finance Fund, Prishtinë Kosovë. Pozicioni: Drejtues Huaje.

Prill 2001-Shtator 2002: Deloitte Touche Central Europe, Këshilltar Financiar.

Prill 2000-Prill 2001: Këshilltar i pavarur.

Shtator 1999-Maj 2001: Lektor i Ekonomikut dhe Marketingut në Fakultetin e Ekonomikut, Universiteti i Tiranës. Gusht 1998-Mars 2000: Albanian American Enterprise Fund (AAEF) Tiranë, Shqipëri. Pozicioni: Drejtues investimesh.

Gusht 1998 -Dhjetor 2000: Ramco International Ltd (Shqipëri). Pozicioni: Drejtor manaxhimi.

Gusht 1997-Korrik 1998: Trans-Republics Trade & Investment Company, Inc. Moskë, Rusi. Pozicioni: Drejtor Finance & Anëtar Bordi.

Shtator 1997-Korrik 1998: Soyuz Financial House. Pozicioni: Analist.



Prill 1996 - Korrik 1997: Fondi Amerikan në Shqipëri. Pozicioni: Drejtues Investimesh.

Projektet kryesore individuale: ·Përgatitja e planit të biznesit për krijimin e Bankës së parë private amerikane në Shqipëri dhe përfaqësuesi i Fondit Amerikan në procesin e marrjes së licensës nga Banka Qendrore. ·Pjesëmarrës në grupin e manaxhimit, përgjegjës për planifikimin dhe zbatimin e shërbimit të depozitave për Fondin Anglo-Adriatik të Investimeve dhe për Fondin e Parë të Investimeve në fillimet e aktivitetit të tyre në Shqipëri. ·Përgatitja e draft-procedurave operacionale për funksionimin e institucioneve ndërmjetëse financiare në Shqipëri.

Korrik 1992-Qershor 1994: Banka Arabe-Shqiptare. Pozicioni: Manaxher finance. Antarësimet në Bordin Drejtues të: INSIG - Kompania kryesore e sigurimeve në Shqipëri. Banka e Shqipërisë - Këshilli Mbikqyrës, Bashkia Tiranës - Këshilli Bashkiak, ISSH - Insituti Sigurimeve Shëndetësore - Këshilli Mbikqyrës, Trans-Republics Trade & Investment Company, Inc. Moskë Rusi. Ramco (UK), Këshilli Mbikqyrës, IDA - Kompania e vetme e distribucionin të filimit në Shqipëri., DENA - Shoqata shqiptare e përpunimit të të dhënave. Anëtarësimet profesionale: ·Shoqata për Manaxhimin dhe Kërkimin Ndërkombëtar. ·Chartered Institute of Bankers ·Shoqata e Kontabilitetit Amerikan ·Chartered Institute of Accounting in England and Wales.

## HASANBELLIU, Artur



Datëlindja: 30.8.1972  
Zona Nr.:  
Lista shumemërore

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228356

**Grupi Parlamentar:** PR

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, anëtar.

Maj 2007-... : Sekretar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

Komisioni hetimor "Mbi përgjimet e paligjshme të telefonave", anëtar.

**Edukimi:** Universiteti Bujqësor, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Tiranë - 1990-1995; Shkolla e Mesme "Ylli i Kuq" Kamëz, Tiranë - 1986-1990.

**Karriera politike:**

Maj 2006 - Nëntor 2006: anëtar i Komisionit Hetimor për hetimin e tregut monopol të telefonisë celulare dhe përgatitjen e rekomandimeve për liberalizimin e këtij tregu në Shqipëri.

**Karriera jopolitike:**

2003 (tetor) e vazhdim: drejtor i Gazetës "Republika", Tiranë; 2000 (mars) - 2003 (tetor): Drejtor administrativ i Hotel "Florida", Durrës; 1999 (gusht) - 2000 (mars): shoqërues i Kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë; 1995 (tetor) - 1998 (gusht): Oficer i Ministrisë së Rendit Publik.



## HOXHA, Mehmet



Datëlindja: 25.8.1968  
 Vendlindja: Devoll  
 Zona Nr.: 87 -  
 Devoll  
 Qarku: Korçë

**Adresa:**

Kuvendi i Shqipërisë  
 Bulevardi "Dëshmorët e  
 Kombit"  
 Tiranë  
 Tel.: 00355 4 234610

**Grupi Parlamentar:** Qendra Demokratike

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, anëtar.  
 Komisioni Hetimor "Për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, z. Theodhori Sollaku", anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë - 1991.

**Karriera politike:**

Deputet i PD-së; 1990 e vazhdim: anëtar i PD-së.

**Karriera jopolitike:**

1991: mjek i përgjithshëm; 1992-1996: specializim në mjekësinë interne; 1996-1998: specializim në alergologji, 1996- : mjek në klinikën e Alergologjisë në QSU "Nënë Tereza", Tiranë; 1996- : pedagog i jashtëm në Fakultetin e Mjekësisë.

**Tituj:** Master në Mjekësi

**Publikime:** 11 artikuj shkencorë botuar në revista europiane; 31 referate shkencorë brenda dhe jashtë vendit; 3 botime brenda vendit; 4 projekte shkencore; 1 libër (bashkautor).

## HOXHA, Fatos



Datëlindja: 22.10.1961  
 Vendlindja: Kukës  
 Zona Nr.: 12  
 Qarku: Kukës

**Adresa:**

Kuvendi i Shqipërisë  
 Bulevardi "Dëshmorët e  
 Kombit"  
 Tiranë  
 Tel.: 00355 4 228356

**Grupi Parlamentar:** PD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, anëtar.

Komisioni Hetimor "Për hetimin e procedurave të tenderimit të rrugës Durrës-Morinë", anëtar.

**Edukimi:** Akademia Ushtarake "Skënderbej"; Akademia e Forcave Speciale, Turqi; Kolegji i Politikanëve të Sigurimit, Tiranë

**Karriera politike:**

Deputet

**Karriera jopolitike:**

Ushtarak. Komandant i trupave "komando" të Republikës së Shqipërisë.

**Publikime:** Publikime të shumta profesionale.



## HOXHA, Flamur



Datëlindja: 1.5.1948  
Vendlindja: Përmet  
Zona Nr.: 89 -  
Përmet  
Qarku:  
Gjirokastrë

Adresa:  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234607

**Grupi Parlamentar:** PSSH

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, anëtar.

**Edukimi:** Instituti i Lartë Bujqësor, Fakulteti i Agronomisë, Tiranë; Kualifikime për mjediset urbane, imputet bujqësore; lulëtarinë dhe gjelbërimet në parqe e lulishte.

**Karriera politike:**

1991: Anëtar i PS-së; 1992-1996 anëtar i Këshillit Bashkiak, Tiranë; Anëtar i KD-së të PS-së, Tiranë; Anëtar i KPD-së të PS-së në të gjitha kongreset e PS-së; Anëtar i komisionit të Bujqësisë pranë kryesisë së PS-së.

**Karriera jopolitike:**

1971-1987: Agronom, përgjegjës dhe drejtues ekonomie në rrethin e Tiranës; 1987 (qershor)-1991 (shkurt): Drejtor i Drejtorisë së Gjelbërimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Ministrinë e Ekonomisë komunale; 1991 (shkurt)-1992 (mars): ministër i Ekonomisë Komunale dhe Mbrojtjes së Mjedisit; 1992 (mars)-1997 (korrik): specialist në Ndërmarrjen e Gjelbërimit, Tiranë; Lektor dhe udhëheqës shkencor për studentë e grupe studentësh.

**Tituj:** Doktor i Shkencave në fushën e Mbrojtjes Urbane.

**Publikime:** "Mbi zhvillimin e parqeve periferike të qyteteve"; "Trajtimi dhe përpunimi i mbetjeve urbane"; "Për shtimin e sipërfaqeve të blerta"; "Mbeturinat urbane dhe përdorimi i tyre në bujqësi"; Albumi "Përmeti"; "Duke u ballafaquar me premtimet"; Dhjetëra tekste problemore në shtypin periodik.

## HOXHA, Eris<sup>1</sup>



Vendlindja: Pogradec  
Zona Nr.: 86  
Qarku: Pogradec

Adresa:  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228248

**Grupi Parlamentar:** PD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, anëtar. Komisioni Hetimor "Për hetimin e procedurave të tenderimit të rrugës Durrës-Morinë", anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i UTRECHT, Hollandë.

**Karriera politike:**

Anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së; anëtar i Komitetit të Orientimit të Politikave (KOP) pranë PD-së (koordinator për Drejtësinë); kandidat për deputet i PD-së në zgjedhjet e 03.07.2005 (zona 85).

**Karriera jopolitike:**

2005-2006: Drejtor i Entit të Turizmit; 2001-2005: Avokat; 1999-2001: Jurist pranë KPN (Hollandë).

**Tituj:** Mester in het Recht (LLM).

**Publikime:** Gjykata Ndërkombëtare (libër); Zgjerimi i BE, sfida të pakapërcyeshme; Çështje Europiane (artikull).

<sup>1</sup> Merr mandatin në korrik 2007. Zëvendëson Besnik Jaçellin.





## HUSHI, Durim



Datëlindja: 9.7.1953  
Vendlindja: Elbasan  
Zona Nr.: 52  
Qarku: Elbasan

**Adresa:**

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234612

**Grupi Parlamentar:** Deputet i pavarur

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë, dega Elektroenergjetikë - 1975.

**Karriera politike:**

1992: kandidat i PS-së për Kryetar Bashkie, Elbasan.

Maj 1996: kandidat i PS-së për deputet, Zona 64.

1997-2001: Prefekt i Qarkut të Elbasanit.

2001-2005: Deputet, zona zgjedhore 50.

2005 - Deputet, zona zgjedhore 52.

Shtator 2005 - 2006: Kryetar i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

**Karriera jopolitike:**

1975-1984: Inxhinier në Kombinatin Metalurgjik, Elbasan; 1984-1990: Drejtor i Uzinës Energjitike, Elbasan; 1990-1997: Inxhinier në Kombinatin Metalurgjik; 1997-2001: Prefekt i Qarkut Elbasan.

## HYSA, Ndriçim



Datëlindja: 12.1.1959  
Vendlindja: Elbasan  
Zona Nr.: 58  
Qarku: Elbasan

**Adresa:**

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234607

**Grupi Parlamentar:** PSSH

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, anëtar. Komisioni Hetimor "Për hetimin e shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit në dispozicion të ministrive, institucioneve kryesore të varësisë dhe ndërmarrjeve publike nëpërmjet prokurimeve publike për periudhën 2001 e në vijim", anëtar.

**Edukimi:**

Instituti i Lartë Bujqësor, Fakulteti i Agronomisë, Tiranë.

**Karriera politike:**

1991: Anëtar i PS-së; 1992-1996: Anëtar i Këshillit të Rrethit, elbasan;

1996-2000: Anëtar i Këshillit Bashkiak, Elbasan; 1991-2000: Anëtar

i Kryesisë së PS-së, Elbasan; 1998 e vazhdim: Anëtar i Komitetit të Përgjithshëm Drejtues të PS-së.

**Karriera jopolitike:**

1983-1988: Agronom, Elbasan, 1988-1991: Kryeagronom, Elbasan,

bashkëpunëtor Shkencor në Institutin e Duhanit, Cërrik, and 1992-

1996: Përgjegjës i zyrës së Bujqësisë, Bashkia Belsh.



## IDRIZI, Shpëtim



Datëlindja: 7.7.1967  
Vendlindja: Tiranë  
Zona Nr.: 37  
Qarku: Tiranë

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234612

**Grupi Parlamentar:** PSSH

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, anëtar.

Komisioni Hetimor "Për zbatimin e ligjit të koncesioneve, dhënien me koncesion të objekteve të ndryshme në pronësi shtetërore, kushtet e dhënies së këtyre kontratave për periudhën 2001 e në vijim dhe procedurat për fillimin e punimeve për ndërtimin e TEC-it të Vlorës" - Kryetar.

**Edukimi:** Fakulteti Ekonomik (Dega Administrim Biznesi)- 1987-1991; Fakulteti Juridik (Dega Juridik) -1999 e vazhdim (Diploma në pritje). Kualifikime: Pjesëmarrës në disa programe trajnimi, organizuar nga institucione të rëndësishme ndërkombëtare.

**Karriera politike:**

Maj 2006 - Nëntor 2006: anëtar i Komisionit Hetimor për hetimin e tregut monopol të telefonisë celulare dhe përgatitjen e rekomandimeve për liberalizimin e këtij tregu në Shqipëri.

**Karriera jopolitike:**

2003 (dhjetor) - 2005 (qershor): Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Drejtor i Përgjithshëm; 002 (gusht) - 2003 (dhjetor): Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Drejtor i Përgjithshëm; 994 (prill) - 2002 (korrik): Firma "Mobil Special" Sh.p.k., administrator; 1993 (tetor) - 1994 (prill): Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Dega e Agjencisë së Privatizimit Tiranë Kryetar; 1993 (shkurt) - 1993 (tetor): Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Përgjegjës i Sektorit të Privatizimit të Madh; 1992 (janar) - 1993 (shkurt): Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Specialist; 1991 (qershor) - 1991 (nëntor): Këshilli i Ministrave, Shef Kabineti pranë Zv /Kryeministrit dhe Ministrit të Financave.

## ISARAJ, Arben



Datëlindja: 21.4.1966  
Vendlindja: Vlorë  
Zona Nr.: 95  
Qarku: Vlorë

**Grupi Parlamentar:** PSSH – Nënkryetar.

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, anëtar.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat (anëtar zëvendësues).

Komisioni Hetimor "Për hetimin e procedurave të tenderimit të rrugës Durrës-Morinë" - Nënkryetar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë - 1988

**Karriera politike:**

2000 e vazhdim: anëtar i PSSH-së. Shtator 2005 - Prill 2007: Anëtar i Komisionit për Sigurinë Kombëtare; Maj 2006 - Korrik 2006: Anëtar i Komisionit Hetimor për Çështjen e Prokurorit të Përgjithshëm.



### Karriera jopolitike:

1988-1990 dhe 1990 e vazhdim: Pedagog në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës; 1994-1995: Zëvendësdekan i Fakultetit të Drejtësisë; 1998: Këshilltar juridik i Kryeministrit; 1999: Këshilltar juridik i Kryeministrit për Çështjet e Sigurimit Kombëtar; 2001-2002: Këshilltar juridik i ministrit të Mbrojtjes; 2002-2004: Këshilltar juridik i Kryeministrit; 1999: Inspektor i Përgjithshëm i SHISH-it; 2004-2005: Zëvendësministër i Rendit Publik; 1990-1991: specializim në Athinë mbi mendimin juridik në botën antike; 1992-1993: specializim në Universitetin e Londrës në fushën e teorisë së politikës; 1993: specializim mbi njohjen e organizatave ndërkombëtare në Bruksel, pranë NATO-s; 1994: specializim në Trento (Itali), mbi mendimin modern mbi të drejtën; 1988-1999: specializim pranë Universitetit Monteskie (Bordeaux IV), Francë, për historinë e së drejtës publike dhe mendimin politik.

### Publikime:

Punime dhe artikuj shkencorë, si dhe tekste universitare.

#### Adresa:

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228248

## ISLAMI, Kastriot



Datëlindja: 18.8.1952  
Vendlindja: Tiranë  
Zona Nr.: 73  
Qarku: Fier

#### Adresa:

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel/Fax:  
00355 4 228526

### Grupi Parlamentar: PSSH

#### Veprimtaria parlamentare aktuale:

Komisioni për Politikën e Jashtme, anëtar.

Maj 2007-... : Bashkëkryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Dega Fizikë Speciale. Doktoratë në fushën e Fizikës Atomike e Molekulare, Universiteti i Parisit XI - 1981-1985. Studime post-doktorate, Universiteti i Giessenit, Gjermani.

#### Karriera politike:

1996 e vazhdim: anëtar i PS-së; 1996-1999: anëtar i Kryesisë së PS-së; 1996-2005: anëtar i KPD të PS-së; 1996-1997: kryetar i Departamentit të Medias dhe Informacionit në PS; 1991-1992: Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë; 1992-1998: kryetar/anëtar i Komisionit për hartimin e Projektushtetutës; 1998-2001: anëtar i Komisionit të Ligjeve dhe Çështjeve Kushtetuese; 2001-2002: sekretar i Komisionit Parlamentar të Politikës së Jashtme; 1991: Ministër i Arsimit; 1997-1998: Ministër i Shtetit; 1998: Zëvendëskryeministër; 2002-2004: Ministër i Financave; 2004-2005: Ministër i Punëve të Jashtme; 1999: Koordinator për Krizën e Kosovës.

#### Karriera jopolitike:

Punonjës kërkimor-shkencor në Fakultetin e Shkencave të Natyrës; Zëvendësdekan i Fakultetit të Shkencave të Natyrës; Zëvendëskryetar i Këshillit Shkencor; Anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Unionit Ballkanik të Fizikës; anëtar i Editorial Board of Journal "Fisica Balkanica".

**Tituj:** Doktor i Shkencave; Profesor.



## JAÇELLI, Besnik<sup>2</sup>



Datëlindja: 3.3.1966  
 Vendlindja: Pogradec  
 Data e vdekjes:  
 27.04.2007  
 Zona Nr.: 86 -  
 Pogradec  
 Qarku: Korçë

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti Gjeologji-Miniera, Dega Gjeologji; Fakulteti i Drejtësisë.

### Karriera politike:

2005: deputet i PD-së. 1997 e vazhdim: anëtar i kryesisë së Degës së PD-së në Pogradec; 2000-2005: kryetar i Komunës Buçimas.

<sup>2</sup> Në korrik 2007 zëvendësohet nga Eris Hoxha.

## JUKA, Genc



Datëlindja: 29.7.1955  
 Vendlindja: Lushnjë  
 Zona Nr.: 30  
 Qarku: Durrës

*Adresa:*  
 Kuvendi i Shqipërisë  
 Bulevardi "Dëshmorët e  
 Kombit"  
 Tiranë  
 Tel.: 00355 4 232575

**Grupi Parlamentar:** Demokrat-Reformator

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Sekretariati për Marrëdhëniet me Jashtë – Anëtar.

Komisioni për Integrimin Europian - Nënkryetar.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin (anëtar zëvendësues).

Komisioni Hetimor "Për hetimin e objektit dhe procedurave të kontratës së privatizimit të Albtelekomit për periudhën 2001 e në vijim", anëtar.

**Edukimi:** Instituti i Lartë Bujqësor Tiranë, Fakulteti Agronomi, dega Mbrojtje Bimësh - 1974-1979.

Patologjia e Bimëve, Fakulteti i Agronomisë (provim pasuniversitar) - 1984.

Gjuha angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (provim pasuniversitar) - 1995

Gjuha italiane, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (provim pasuniversitar) - 1995

Trajnime dhe kualifikime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit:

1993: Mekanizmi bujqësor, Suedi; 1993: Përdorimi i halofiteve në bujqësi - CIHEAM, Itali; 1994: Procedurat dhe konditat e Disbursimit të Bankës Botërore (Banka Botërore, Washington DC); 1994: Zhvillimi i integruar i Rajoneve Malore (Geneve University, Zvicër); 1995: Financimi i Projekteve Ndërkombëtare (USAID, Tiranë); 1995:



Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, dega Jurisprudencë - 1970.

**Karriera politike:**

1991: bashkohet me Lëvizjen demokratike; anëtar i Kryesisë së PD-së; sekretar për Marrëdhëniet me Publikun i PD-së; 1997: ministër i Drejtësisë në Qeverinë e Pajtimit Kombëtar; 2001-2003: nënkryetar i Komisionit të Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë; Shtator 2005 - Prill 2006: Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

**Karriera jopolitike:**

1970: Zyra e Ndihmës Juridike, Vlorë; 1972: Prokuroria e Rrethit Durrës; 1973: punonjës shkencor në Institutin e Historisë, Tiranë; 1976 dhe 1979-1990: dënuar për "Agjitacion e Propagandë" në burgun e Burrelit; 1991 e vazhdim: Avokat në Studion e tij Ligjore.

**Tituj:** Avokat.

**Publikime:** Artikuj të shumtë në shtypin demokratik shqiptar; romanet: "Shpella e Vdekjes" dhe "Helena R".



## NISHANI, Bujar



Datëlindja: 29.9.1966  
Vendlindja: Durrës  
Zona Nr.: 34  
Qarku: Tiranë

**Adresa:**

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234607

**Grupi Parlamentar:** PD

**Funksioni aktual:** Ministër i Brendshëm.

**Edukimi:** Akademia Ushtarake "Skënderbej" - 1988; Universiteti i Tiranës, Fakulteti Juridik - 2004; Pasuniversitare, Kaliforni (ShBA) - 1996; Master për Studime Europiane - 2004 vazhdim.

**Karriera politike:**

2001: Sekretar i Përgjithshëm, dega PD-së, Tiranë; 2003: anëtar i Këshillit Bashkiak, Tiranë; 2004: anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së; 2005: anëtar i Kryesisë së PD-së; Shtator 2005 - Mars 2007: Sekretar i Komisionit për Sigurinë Kombëtare; Maj 2006 - Korrik 2006: Anëtar i Komisionit Hetimor për Çështjen e Prokurorit të Përgjithshëm; deri në Prill 2007: anëtar i Sekretariatit për Procedurat e Votimit.

**Karriera jopolitike:**

1988: pedagog, Akademia Ushtarake Skënderbe; 1993: Ministria e Mbrojtjes, marrëdhëniet me Jashtë; 1994: Ministria e Jashtme, marrëdhëniet me NATO-n; 1996: Ministria e Mbrojtjes, Kabineti i Ministrit; 1997: në profesion të lirë, Kryetar i Forumit të Ushtarakëve Euro-Atlantikë; Bordi i Institutit "Goethe".

**Tituj:** Kandidat për Master në Studimet Europiane

## OKETA, Gazmend



Datëlindja: 14.12.1968  
Vendlindja: Durrës  
Zona Nr.: 29  
Qarku: Durrës

**Adresa:**

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 232602

**Grupi Parlamentar:** PD

**Funksioni aktual:** Zëvendëskryeministër.

**Edukimi:** Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.

**Karriera politike:**

1990: anëtar i Lëvizjes Studentore; 1991: anëtar i grevës së urisë së studentëve; 2003: anëtar i Këshillit Bashkiak, Durrës, grupimi i PD-së; 2004: nënkryetar i Degës së PD-së, Durrës; Shtator 2005 - Prill 2006: Anëtar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat; Prill 2006 - Mars 2007: Anëtar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut; Maj 2006 - Korrik 2006: Anëtar i Komisionit Hetimor për Çështjen e Prokurorit të Përgjithshëm; deri në Prill 2007: anëtar i Sekretariatit për Statusin e Deputetit.

**Karriera jopolitike:**

1993-1995: asistent pedagog në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit; 1995-1997: njësia e menaxhimit të Projektit të Bankës Botërore për Rehabilitimin e Ujësjellësit të Durrësit- specialist supervisor; 1997-2001: administrator dhe manaxher i Shoqërisë "Teuta Konstruksion" sh.p.k.; 2001 e vazhdim: aktivitet privat, drejtues ligjor i Firmës G+A sh. p. k.; Konsulent projektues edhe për Kompani të huaja.



## OLLDASHI, Sokol<sup>4</sup>



Datëlindja: 17.12.1972  
Vendlindja: Durrës  
Zona Nr.: 26  
Qarku: Durrës

**Adresa:**

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234607

**Funksioni aktual:**

Ministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.  
**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë -1995; Kolegji i Mbrojtjes pranë Komandës së Doktrinave (Politikat e Sigurimit Kombëtar) - 2004

**Karriera politike:**

2005- 2007 (shkurt): deputet i PD-së dhe Ministër i Brendshëm.  
2002 - : Kryetar i Forumit Rinor të PD-së; 2005 (maj) e vazhdim: Kryetar i PD-së së Tiranës; 2001-2005 (maj) deputet: nënkryetar i Komisionit të Përhershëm të Mandateve, Imunitetit dhe Rregullores; anëtar i Komisionit të Punëve të Jashtme; Kryetar i Komisionit Hetimor për shqyrtimin e ligjshmërisë së përdorimit të fondeve në Ministrinë e Kulturës dhe Bashkinë e Tiranës si dhe zbatimin e ligjshmërisë për zhvillimin urbanistik në Tiranë.

**Karriera jopolitike:**

1999-2001: Kryeredaktor në Televizionin ATN1; 1995-1999: Zv/ kryeredaktor për politikën në gazetën "Albania"; 1994-1996: reporter pranë ATSH-së. **Tituj:** Diplomuar me "Medalje të Artë" - Shkolla e Mesme e Përgjithshme "Naim Frashëri", Durrës.

<sup>4</sup> Lë mandatin dhe konkuron për Kryetar Bashkie (Zgjedhjet e 18 shkurtit 2007). Zëvendësohet nga Osman Metalla.

## PALOKA, Edi<sup>5</sup>



Vendlindja: Tiranë  
Zona Nr.: 31  
Qarku: Tiranë

**Adresa:**

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 232602

**Grupi Parlamentar:** PD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, anëtar. Komisioni Hetimor "Për hetimin e shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit në dispozicion të ministrive, institucioneve kryesore të varësisë dhe ndërmarrjeve publike nëpërmjet prokurimeve publike për periudhën 2001 e në vijim" - Nënkryetar.

**Edukimi:** Universiteti Shtetëror i Tiranës.

Kurse e Diploma në Gazetari dhe fusha të ndryshme të politikës.

**Karriera politike:**

2001-2005: Deputet i Kuvendit të Shqipërisë. Anëtar i Kryesisë së PDSH-së. 1999-2005: Zëdhënës i PDSH-së.

**Karriera jopolitike:**

1991-1999: Gazetar dhe Zv.Kryeredaktor i gazetës "Rilindja Demokratike"; Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Telegrafike Shqiptare; President i Aleancës së Agjencive të Lajmeve të Mesdheut.

**Tituj:** Inxhinier

**Publikime:** Artikuj në shtypin shqiptar dhe të huaj.

<sup>5</sup> Merr mandatin në tetor 2007. Zëvendëson Bamir Topin.





## PANGO, Ylli



Datëlindja: 26.3.1952  
Vendlindja: Tiranë  
Zona Nr.: 38  
Qarku: Tiranë

**Adresa:**

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234607*

**Grupi Parlamentar:** PD

**Funksioni aktual:**

Ministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Dega Matematikë 5-vjeçare; Studime pasuniversitare në fushën Planifikim-Administrim të Arsimit në Universitetin e Bostonit, USA (Humphrey Fellowship Program, Fulbright Exchange Program) - 1994-1995 (Diploma e këtyre studimeve është firmosur nga presidenti Bill Clinton); studime pasuniversitare në fushën e Psikologjisë në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës; universitetet e Barit-Itali, Granatës- Spanjë, Leuvenit-Belgjikë, Montpellier-Francë dhe në Universitetin e Washingtonit, Seattle-USA. Zotëron me diploma gjuhët anglisht dhe frengjisht.

**Karriera politike:**

Shtator 2005 - Mars 2007: Nënkretar i Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Angazhuar që në fillimin e lëvizjes demokratike në vitin 1990 me shkrime të shumta në RD, Republika etj., kundër diktaturës, figurave të regjimit totalitar etj.

Ka qenë një nga firmëtarët e parë të themelimit të Partisë Demokratike i thirrur nga Azem Hajdari në Qytetin Studenti për t'u folur studentëve e për të firmosur.

Në Institutin e Studimeve Pedagogjike ku punonte në fillimin e viteve '90 ka mbledhur firmat e punonjësve të këtij Instituti për të kërkuar themelimin e Partisë Demokratike.

Nga viti 1997-1998 e deri më sot ka shkruar e polemizuar në të gjitha gazetat e televizionet kundër qeverisjes së korruptuar të partisë socialiste.

Në mars 2003 goditet pabesisht me një bombë në garazhin e shtëpisë, nga e cila merr plagë të rënda. Operohet në bark, dhe ka rreth 40 copë predha ende në të dyja këmbët. Qeveritarët aktualë, ish shefi i policisë i Tiranës i asaj kohe dhe kryetari i bashkisë së Tiranës u përpoqën të sajojnë legjenda për vendosjen e bombës, manipuluan mediat por së fundmi pas gjashtë muajsh, vetë shefi i ndjekjes së krimeve Sokol Bizhga, u detyrua të pranojë në televizion se vënja e bombës në shtëpinë e Ylli Pangos ishte një vepër terroriste. Deri më sot qeveritarët as janë munduar e as kanë dashur të zbulojnë asgjë mbi autorët e kësaj vepre terroriste.

Pas kësaj ngjarje dhe pas disa muaj qëndrimi në shtrat Ylli Pango boton librin *Krim* ku përshkruan atentatin ndaj tij dhe dyshimet për autorët e tij si dhe bën analizën e kriminalitetit në Shqipëri gjatë qeverisjes socialiste. Qysh prej një viti është aktivizuar pranë Kryetarit Berisha si hartues i platformës për arsimin për qeverisjen e ardhme të PD dhe si anëtar i KOP-it. Anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së.



### Karriera jopolitike:

1992-1994: zëvendësministër i Arsimit (larguar për studime në SHBA), nënkryetar i Komisionit të Lartë të Kualifikimit Shkencor të Shqipërisë, Kryetar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar; 1999-2005: dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës; 1995-1996: drejtues-menaxher në Fondin Shqiptaro-Amerikan të Investimeve; drejtues i Seksionit të Psikologjisë e Pedagogjisë në Institutin e Studimeve Pedagogjike Tituj: Profesor; Doktor i Shkencave Psikologjike

**Publikime:** Autor i 11 librave dhe qindra artikujve e studimeve shkencore në fushën e studimeve psikologjike, sociale e politike. Ndër librat përmenden: - Psikoterapi - prej rreth 840 faqe - Metodatat Statistike në Studime Psikologjike - Psikologjia e të menduarit të fëmijës - Të fshehtat e kujtesës - Amerika, - Psikologji Sociale; - Edukimi qytetar - Edukim për Demokraci (shqip dhe anglisht) - Prostitucioni - Një plagë e hapur e shoqërisë shqiptare, - Krim,. **Drejtues apo pjesëmarrës hartues projektsh kombëtare e ndërkombëtare**

- Pjestar i grupit drejtues të ekspertëve dhe bashkautor i “**Human Development Report**” 1997-1998 (Kapitulli i problemeve sociale) (Raporti i Zhvillimit Human në Shqipëri). Botim i **PNUD**

- Psikologjia e moshës e rinisë shkollore (studim kombëtar) - Mid term Plan for education sektor (500 faqe). (Drejtues i hartimit të strategjisë së arsimit kombëtar 1993 dhe i Botimit me të njëjtin titull). - High education in Europe (1993-1994) (Bashkautor me kapitullin “High Education in Albania”) (Botim i Këshillit të Europës)

## PATOZI, Astrit



Zona Nr.: 44  
Qarku: Tiranë

Adresa:  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 232602

**Grupi Parlamentar:** PD – Kryetar.

**Veprimtaria parlamentare aktuale:** Konferenca e Kryetarëve - Anëtar (Kryetar i Grupit Parlamentar të PD-së).

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori-Filogji, Dega Gjuhë-Letërsi.

### Karriera politike:

1997 e vazhdim: anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së; 2002 e vazhdim: anëtar i Kryesisë së PD-së; 1997 e 2001: kandidat për deputet; Shtator 2005 - Mars 2007: Anëtar i Komisionit për Politikën e Jashtme; Maj 2006 - Korrik 2006: Kryetar i Komisionit Hetimor për Çështjen e Prokurorit të Përgjithshëm; Shtator 2007- Kryetar i Grupit Parlamentar të PD-së.

### Karriera jopolitike:

1992-1995: gazetar në ATSH dhe më pas në Gazetën “Rilindja”; 1995-1997: kryeredaktor i Gazetës “Albania”; 1997-2005: kryeredaktor i Gazetës “Rilindja Demokratike”.



## PATURRI, Hajrulla



Datëlindja: 14.4.1966  
Vendlindja: Krujë  
Zona Nr.:  
Lista shumëmeërore

*Adresa:*

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234607*

**Grupi Parlamentar:** PR

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, anëtar.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (anëtar zëvendësues).

Komisioni Hetimor "Për hetimin e objektit dhe procedurave të kontratës së privatizimit të Albtelekomit për periudhën 2001 e në vijim", anëtar.

**Edukimi:** Instituti i Lartë Bujqësor, Fakulteti Ekonomik, Dega Financë - 1988.

**Karriera politike:**

Anëtar i PR-së.

**Karriera jopolitike:**

1988-1991: Kryetar i Degës së Financës në Kooperativën Bujqësore, Borizanë; 1992-2005: aktivitet privat.

## PEÇI, Spiro



Datëlindja: 17.2.1947  
Vendlindja: Delvinë  
Zona Nr.: 98 -  
Delvinë - Himarë  
Qarku: Vlorë

*Adresa:*

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228248*

**Grupi Parlamentar:** Qendra Demokrate

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Byroja e Kuvendit - Sekretar për Kërkimin Shkencor, Bibliotekën dhe Botimet.

Sekretariati për Kërkimin Shkencor, Bibliotekën dhe Botimet – Sekretar.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, anëtar.

Maj 2007-... : Anëtar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

**Edukimi:** Fakulteti i Shkencave Politiko-Juridike, dega Juridik - 1965-1969.

**Karriera politike:**

2005: deputet i pavarur; 2002 (shkurt) - 2003 (dhjetor): Ministër i Drejtësisë; anëtar i Kryesisë së PBDNJ.

**Karriera jopolitike:**

1970-1991: ndihmësprokuror dhe Prokuror i Rrethit Sarandë; 1991-1992: Zëvendësprokuror i Përgjithshëm i Republikës; 1992-1995: drejtor Drejtorie dhe Prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme; 2002-2003: Ministër i Drejtësisë; 2004-2005: Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.



## PERNASKA, Lajla



Datëlindja: 14.6.1961

Vendlindja: Tiranë

Zona Nr.:

Lista shumemërore

*Adresa:*

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"*

*Tiranë*

*Tel/Fax: 00355 4*

*228526*

**Grupi Parlamentar:** PR - Nënkryetare

**Veptrimaria parlamentare aktuale:** Komisioni për Politikën e Jashtme, anëtare. Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë (anëtare zëvendësuese).

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, Dega Mjekësi e Përgjithshme - 1985; Universiteti "René Descartes", Paris, Dega Pediatri e Përgjithshme - 1994; Universiteti "Henri Poincare", Francë, Politika shëndetësore dhe zhvillimi - 2000.

- Studime në Marrëdhënie Ndërkombëtare (IRERIE - Francë) - Master (2006).

- Studime Europiane (SHPUSE - Tiranë) - Kandidate master (2007).

**Karriera politike:**

Maj 2006 - Tetor 2006: anëtare e Komisionit Hetimor për Hetimin e Shkarkimeve në Administratë. 1995-2005: anëtare e Lidhjes Demokratike të Gruas; 1999-2002: drejtuese e Departamentit të Politikave sociale e gjinore pranë PD-së.

**Karriera jopolitike:**

1985-1988: mjekë në Institutin e Pediatrisë; 1989-1994: mjekë në spitalet Saint-Vincent de Paul dhe Necker, Paris; 1995-1997: këshilltare e ministrit të Shëndetësisë; 1998: drejtore e Programit NESMARK; 1997-1999: drejtuese e Federatës së Gruas shqiptare; prej 2000: drejtuese e Unionit "Gjinia dhe Zhvillimi"; 2001-2005: konsulente kombëtare pranë organizmave Botërore si UNICEF, PNUD Banka Botërore Organizata Botërore e Shëndetësisë.

**Tituj:** Master në Politikat Shëndetësore dhe të Zhvillimit.

**Publikime:** Librat "Për fëmijën tuaj", "Zhvillimi psikologjik i fëmijëve", "Të rinjtë dhe shëndeti riprodhues"; Platforma "Gruaja, familja, shoqëria", "Balanca gjinore në politikë", "Antistres", "Udhërrëfyes i adoleshencës".

## POLLO, Genc



Datëlindja: 1963

Vendlindja: Tiranë

Zona Nr.:

Lista shumemërore

**Grupi Parlamentar:** Demokrat-Reformator

**Funksioni aktual:**

Ministër i Arsimit dhe Shkencës.

**Edukimi:** Diplomuar në Shkencat Historike në Universitetin e Tiranës - 1986.

**Karriera politike:**

1990 (dhjetor) -1992: Bashkëthemelues i Partisë Demokratike dhe zëdhënës i parë i saj; 1992-1996: Këshilltar i Presidentit të Republikës së Shqipërisë; 1993: Anëtar themelues dhe Nënkryetar i Shoqatës Shqiptare të Atlantikut; 1996: Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, anëtar i Komisionit Parlamentar të Punëve të Jashtme dhe kryetar i Nënkomisionit Parlamentar të Integritimit Europian; 1997 (shkurt): sekretar i Marrëdhënieve me Jashtë i Partisë Demokratike; 1997



(mars): Kryetar i Komisionit Parlamentar të Punëve të Jashtme; 1997 (prill): Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Demokratike; 1997 (qershor): Deputet i Partisë Demokratike në Kuvendin e Shqipërisë; 1997 (shtator): Nënkryetar i Partisë Demokratike dhe Kryetar i Grupit Parlamentar të saj.

Që nga viti 1999 është përfaqësues kryesor i Lëvizjes Reformatore brenda Partisë Demokratike. 2001 (janar): Kryetar i Partisë Demokratike të Re.

#### **Karriera jopolitike:**

1986-1988: kërkues shkencor në Akademinë e Shkencave; 1988-1990: Studime pasuniversitare në Universitetin e Vjenës, me bursë të akorduar nga qeveria austriake.

---

#### **Adresa:**

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel/Fax:  
00355 4 228526*

---

## PRENGA, Gjovalin



Datëlindja: 13.6.1963

Vendlindja: Rubik

Zona Nr.: 15 -

Mirditë

Qarku: Lezhë

---

#### **Adresa:**

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228356*

**Grupi Parlamentar:** Demokrat-Reformator

#### **Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, anëtar.

Komisioni Hetimor "Për hetimin e procedurave të tenderimit të rrugës Durrës-Morinë", anëtar.

**Edukimi:** Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, Fakulteti Biologji-Kimi - 1986; Specializuar në UT, Fakulteti i Shkencave të Natyrës.

#### **Karriera politike:**

2005: deputet i PD-së; 1996-2003: Kryetar i Bashkisë, Rubik (kandiduar nga PD); 2003-2005: kryetar i Degës së PD-së, Mirditë.

#### **Karriera jopolitike:**

1986-1989: mësues në Shkollën e Mesme të Bashkuar, Reps; 1989-1992: specialist në Kabinetin Pedagogjik, Rrëshen; 1992-1996: ekspert kriminalist në Komisariatin e Policisë, Rrëshen; 1996-2003: Kryetar i Bashkisë, Rubik; 2003-2005: Partner Lokal i Urban Institute, USAID.



## PRIFTI, Dritan



Datëlindja: 27.8.1968

Vendlindja: Berat

Zona Nr.:

Lista shumemërore

**Adresa:**

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"*

*Tiranë*

*Tel.: 00355 4 234612*

**Grupi Parlamentar: LSI&PDS**

**Vepërmtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat , anëtar.

Komisioni Hetimor "Për hetimin e shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit në dispozicion të ministrive, institucioneve kryesore të varësisë dhe ndërmarrjeve publike nëpërmjet prokurimeve publike për periudhën 2001 e në vijim", anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori-Filogjji, Dega Gjuhë Angleze - 1986-1990; Master në Administrim Biznesi, Shkolla e Menaxhimit R.O. Anderson, Universiteti i New Mexico, NM, USA - 1993-1995; Master në Administratë Publike, Shkolla e Qeverisë Kennedy, Universiteti Harvard, Cambridge, MA, USA - 1999-2000.

**Karriera politike:**

2001 (qershor) - vazhdim: Kuvendi i Shqipërisë, deputet, përfaqësues i PS i zonës 70, Fier (2001-2005); deputet i LSI (2005-2009).

2001 (shtator) - 2002 (mars): Këshilli i Ministrave - Ministër Shteti për Energjetikën.

2000 (nëntor) - 2001 (shtator): Korporata Elektroenergjitike Shqiptare - Drejtor i Përgjithshëm.

2000 (korrik) - 2000 (tetor): Këshilli i Ministrave - Drejtor i Kabinetit të Kryeministrit (Z. Ilir Meta).

1998 (tetor)-1999 (korrik): Ministria e Financave - Shef i Kabinetit të Ministrit.

1997 (shtator) - 1998 (shtator): Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale - Shef i Kabinetit të Ministrit.

**Karriera jopolitike:**

1995 (dhjetor) -1997 (tetor): ALDRI shpk, President dhe Administrator i një firme konsulence dhe eksport-importi; 1995 (shkurt) -1997 (mars): THE ALLIANCE GROUP, Inc. me qendër në Albuquerque New Mexico USA Drejtor për Europën Lindore në shoqëri eksport-importi dhe konsulence; 1992 (shtator) -1993 (mars): INSIG, specialist për marrëdhëniet me jashtë dhe risigurimin; 1991 (qershor) -1993(mars): ALBA-TREG, Zv. President dhe Drejtor i Marketingut për kompani tregtare dhe prodhuese.

**Tituj:** 2 Mastera



## RAMADHI, Galip



Datëlindja: 23.12.1950  
Vendlindja: Kavajë  
Zona Nr.:  
Lista shumemërore

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228248

**Grupi Parlamentar:** PR

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, anëtar.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin (anëtar zëvendësues).

Komisioni Hetimor "Për hetimin e objektit dhe procedurave të kontratës së privatizimit të Albtelekomit për periudhën 2001 e në vijim", anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, dega Matematikë - 1974.

**Karriera politike:**

1992: kryetar i Këshillit Pluralist të Rrethit Kavajë; 1993-1996: deputet i PD-së në Kuvendin e Shqipërisë; 1996-1997: deputet i PD-së në Kuvendin e Shqipërisë; 2000-2003: Nënkryetar i Bashkisë së Qytetit Kavajë; 2003: anëtar i Këshillit të Bashkisë së Qytetit Kavajë dhe Këshillit të Qarkut Tiranë.

**Karriera jopolitike:**

1974-1989: mësues matematike në Shkollën e Mesme të Përgjithshme, Kavajë; 1989-1990 drejtor i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Kavajë; 1990-1991 përgjegjës i Zyrës së Arsimit të Rrethit Kavajë.

## RUÇI, Gramoz



Datëlindja: 6.12.1951  
Vendlindja: Tepelenë  
Zona Nr.: 91 -  
Tepelenë  
Qarku:  
Gjirokastrë

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 232575

**Grupi Parlamentar:** PSSH

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Këshilli për Legjislacionin – Anëtar.

Komisioni për Integrimin Europian, anëtar.

**Edukimi:** Instituti i Lartë Pedagogjik, Shkodër e Gjirokastrë, dega Bio-Kimi. Mbaruar provimet pasuniversitare.

**Karriera politike:**

2001-2005 dhe 1997-2001: deputet dhe kryetar i Grupit parlamentar të PSSH-së; 1998-1999: Sekretar organizativ dhe kryetar i grupit të PS-së; 1996 (qershor)-1997 (qershor): emigrant; 1992-1996: deputet; 1991-1992: deputet; 1991 (shkurt-qershor): ministër i Punëve të Brendshme; 1978-1991: nëpunës në organet partiake dhe shtetërore.

**Karriera jopolitike:**

1971-1978: arsimtar.



## RULI, Genc



Datëlindja: 11.4.1958  
Vendlindja: Tiranë  
Zona Nr.: 90  
Qarku:  
Gjirokastrë

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228248

**Grupi Parlamentar:** PD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë - 1981; Universiteti i Tiranës, Fakulteti Juridik - 1982; UT - Gradë shkencore "Doktor në Ekonomi", Fakulteti i Ekonomisë - 1986; UT - Fakulteti i Ekonomisë, Titulli Profesor - 1994.

**Karriera politike:** 1991 dhe 1992-1996: deputet; 1994-1996: kryetar i Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financës.

**Karriera jopolitike:** 1996 e vazhdim: pedagog i Kontabilitetit në Fakultetin Ekonomik, UT, 1996- e vazhdim: Instituti i Studimeve Bashkëkohore - President, 1992-2005(maj): kryetar i Këshillit Mbikqyrës të INSIG-ut, 1994-1996: kryetar i Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financës, 1992-1993: Ministër i Financave dhe Ekonomisë, 1982-1990: pedagog i Financës dhe Kontabilitetit në Fakultetin Ekonomik, UT, Angazhime të tjera: anëtar i Bordit Botues të Revistës "Studime të Europës Juglindore dhe Detit të Zi", anëtar i Bordit Këshillimor "Qendra Kërkimore e Europës Juglindore", Selanik, and 2000 e në vazhdim: Zv/President i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar.

**Tituj:** Profesor Doktor në Ekonomi.

## RUSMALI, Ilir



Datëlindja: 24.4.1965  
Vendlindja: Elbasan  
Zona Nr.: 83  
Qarku: Korçë

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë

**Grupi Parlamentar:** PD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Maj 2007-... : Bashkëkryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

**Edukimi:** Shkurt 1992 - Mars 1994: Kurs Studimesh pasuniversitare (Kurzzeitstudium) në specialitetet: E drejta Kushtetuese, të Drejtat e Njeriut dhe e Drejta Ndërkombëtare Publike pranë Institutit "Max-Planck" të së drejtës Ndërkombëtare në Heidelberg dhe në Univeristetin e Heidelbergut, Gjermani.

Shtator 1983 - Qershor 1987: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.

**Karriera politike:**

Dhjetor 1987 - Gusht 1991: Sektori shkencor i Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës. Specialiteti: E Drejta Kushtetuese e Krahasuar. Prill 1995 - Qershor 1996: Ndihmës Ligjor i Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë. Korrik 1996 - Qershor 1997: Këshilltar Ligjor i Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Korrik 1997 - Shtator 1997: Këshilltar Ligjor i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Maj 1998 - Dhjetor 2001: Konsulent juridik, Studio Ligjore Legibus, Janar 2002 - Prill 2005: Sekretar i PD-së për Zgjedhjet dhe Çështjet Ligjore. Prill 2005: Sekretar i PD-së për Çështjet Ligjore. Korrik





2005: Deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Shtator 2005 - Mars 2007: Zëvendëskryeministër (emëruar me dekretin e Presidentit të Republikës nr.4646, datë 07. 09. 2005 Për emërimin e Këshillit të Ministrave; Mars 2007 – Nëntor 2007: Ministër i Drejtësisë.

Veprimtari të tjera: Dhjetor 1996 - Dhjetor 2000: Anëtar i Komisionit të Letrave me Vlerë (Komisioni Mbikëqyrës i Bursës). Emëruar nga Kuvendi, me mandat pesëvjeçar. Shkurt 1998 - Dhjetor 2001: Bashkëthemelues dhe Drejtor i shoqatës “Individi dhe Ligji”, OJQ shqiptare që merret me edukimin ligjor dhe me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Gusht 2000 - Shtator 2001: Pjestar i Klinikës Ligjore për të Miturit, e cila u jep asistencë ligjore sociale dhe psikologjike të miturve që kanë probleme me drejtësinë. Tetor 2001 - Dhjetor 2001: Pjestar në Zyrën për Mbrojtjen e Qytetarëve, e cila u jep asistencë ligjore viktimave të korrupsionit. Tetor 2000 - Tetor 2003: Anëtar i Këshillit Bashkiak Tiranë, pjestar i grupit të këshilltarëve të PD-së. Tetor 2003 - Korrik 2005: Anëtar i Këshillit Bashkiak Tiranë, kryetar i grupit të këshilltarëve të PD-së. Prill 2005: Zgjedhur anëtar i Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike nga Kuvendi Kombëtar i PD-së, and zgjedhur anëtar i Kryesisë së PD-së nga Këshilli Kombëtar .

## SHARKU, Genc



Datëlindja: 5.5.1965

Vendlindja: Bulqizë

Zona Nr.:

Lista shumemërore

Adresa:

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi “Dëshmorët e  
Kombit”

Tiranë

Tel.: 00355 4 232575

Grupi Parlamentar: PR

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Integrimin European, sekretar.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat (anëtar zëvendësues).

Komisioni i Posaçëm për Integrimin në NATO, anëtar.

Komisioni Hetimor “Për zbatimin e ligjit të koncesioneve, dhënien me koncesion të objekteve të ndryshme në pronësi shtetërore, kushtet e dhënies së këtyre kontratave për periudhën 2001 e në vijim dhe procedurat për fillimin e punimeve për ndërtimin e TEC-it të Vlorës”, anëtar.

**Edukimi:** Akademia e Arteve; Fakulteti Ekonomik.

**Karriera jopolitike:**

1990 - Orkestra e Teatrit të Estradës, Tiranë; 1996-2000: drejtor i Teatrit të Varietesë, Tiranë; 2000-2005: menaxher-biznes pranë Firmës “Al-Dur Invest”.



## SHEHI, Baki



Datëlindja: 28.11.1950

Vendlindja: Tiranë

Zona Nr.: 47

Qarku: Tiranë

Adresa:

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228356

**Grupi Parlamentar:** PAA

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, anëtar.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë (anëtar zëvendësues).

**Edukimi:** Shkolla e Bashkuar e Oficerave -1971; Akademia Ushtarake (përgatitje e kuadrove të Shtabit të Përgjithshëm) - 1980; kursi i Lartë i Filozofisë 1984-1985; kurs kualifikimi ushtarak (pas Akademisë) 1988-1989; Akademia e Forcave të Armatosura Turke (Kolegji i NATO-s), Stamboll - 1995-1996.

**Karriera politike:** 2005; deputet i PD-së; 1991-1992: kryetar i Komisionit Parlamentar të Mbrojtjes, Rendit e SHIK-ut; 2001-2004: kryetar i PD-së të Zonës 36, Tiranë; 2001-2004: anëtar i Kryesisë së PD-së, Dega Tiranë.

**Karriera jopolitike:** 1991-1992: drejtor Personeli në Ministrinë e Mbrojtjes; 1992-1993: Zv/Ministër i Mbrojtjes; 1993-1995: Zv/Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë; 1996-1997: drejtor i Logjistikës së Ushtrisë. **Tituj:** Kolonel -1991; Gjeneral Brigade - 1993; Gjeneral Major - 1995.

**Publikime:** Artikuj të ndryshëm në shtypin shqiptar si "RD", "Albania", "55", "Tema" dhe në Revistën "Strategjia dhe Politika" - revistë e Institutit të Sigurimit dhe Mbrojtjes.

## SHEHU, Sali



Datëlindja: 10.12.1962

Vendlindja: Dibër

Zona Nr.: 20 -

Bulqizë

Qarku: Dibër

Adresa:

Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228248

**Grupi Parlamentar:** PD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut - Sekretar. Komisioni hetimor "Mbi përgjimet e paligjshme të telefonave", anëtar.

**Edukimi:** Akademia e Lartë e Oficerave të Policisë, Tiranë - 1993; Universiteti i Tiranës, Fakulteti Juridik - 1997; Master në Drejtësi (E drejta Penale) - 2005; specializim për luftën kundër Krimit Ekonomik - 1996

**Karriera politike:** 2002-2005: anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së; 2005 e vazhdim: anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së; 1996-1997: përfaqësues i Shqipërisë në KE, Strasburg; anëtar i Komitetit të Luftës kundër Krimit; 1997(mars-korrik): drejton forcat e policisë për mbrojtjen e Tiranës dhe Institucioneve të Shtetit nga të ashtuquajturat "Komitete të Shpëtimit Kombëtar"; 1997(gusht): shkarkohet nga detyra; 1998: përfaqësues i PD-së në emisionin televiziv në TVSH "E diela debat"; 1998-1999: i burgosur për motive politike; 1999-2000: arrest shtëpie për motive politike.

**Karriera jopolitike:** 1989-1995: inspektor krimesh, shefi i Krimeve për qytetin shef i Policisë Kriminale në Komisariatin e Rrethit Shkodër; 1995(shtator): shefi i Policisë Kriminale në Komisariatin e Rrethit Durrës; 1995-1997: shefi i Komisarariatit të Policisë Nr.2, Tiranë. **Tituj:** Kolonel



## SHEHU, Tritan



Datëlindja: 24.4.1949  
Vendlindja: Tiranë  
Zona Nr.:  
Lista shumemërore

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234610

**Grupi Parlamentar:** Demokrat-Reformator – Kryetar.

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Sekretariati për Marrëdhëniet me Jashtë – Anëtar.

Konferenca e Kryetarëve - Anëtar (Kryetar i Grupit Parlamentar Demokrat - Reformator).

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë - Kryetar.  
Maj 2007-... : Anëtar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë; specializuar Anestezi-Reanimacioni; Menaxhim Shëndetësor.

**Karriera politike:**

Deputet në Legj.XII-XV; 1992-1994: Ministër i Shëndetësisë; 1996-1997: Ministër i Jashtëm e Zv/Kryeministër; 1994-1996: Sekretar i Përgjithshëm i PD-së; 1996-1997: Kryetar i PD-së; 2002 e vazhdim: Zv/kryetar i PDr-së.

**Karriera jopolitike:**

1975: mjek në QSUT; 1979-2005: pedagog në Fakultetin e Mjekësisë, Shef i Shërbimit të Anestezi-Reanimacionit; 1987 e vazhdim: kryetar i Shoqatës së Anestezi-Reanimacionit.

**Tituj:** Profesor Doktor i Shkencave

**Publikime:** Artikuj, libra referime etj.

## SHERIFI, Elmaz



Datëlindja: 28.12.1951  
Vendlindja: Tepelenë  
Zona Nr.: 59 -  
Gramsh  
Qarku: Elbasan

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 228248

**Grupi Parlamentar:** PSSH

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Këshilli për Legjislacionin – Anëtar.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën publike dhe të Drejtat e Njeriut, anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike.

**Karriera politike:**

1992-1996: Anëtar i KPD-së të PS-së prej vitit 1992; 1996-2000: Anëtar i Kryesisë së PS-së; 1997 (mars-korrik): Ministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas në Qeverinë e Pajtimit Kombëtar; 1997-1998: Ministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas; Anëtar i Komitetit Drejtues për Politikën zgjedhore prej vitit 2003; Kryetar i Komisionit të Punës e Çështjeve sociale në Kuvend.

**Karriera jopolitike:**

1967-1970: Ndërmarrja Komunale, Tepelenë; 1973-1976: Përgjegjës i seksionit elektrik; 1976-1977: Ndërmarrja e Ndërtimit, Tepelenë; 1980-1983: Drejtor i Ndërmarrjes së Ndërtimit, Tepelenë.

**Publikime:** Libri "Një dekadë në politikë".



## SHPANI, Ndue



Datëlindja: 16.6.1959  
Vendlindja: Mat  
Zona Nr.:  
Lista shumemërore

**Adresa:**

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234612*

**Grupi Parlamentar: Demokristian  
Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, anëtar.

Maj 2007-... : Anëtar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

Komisioni Hetimor "Për zbatimin e ligjit të koncesioneve, dhënien me koncesion të objekteve të ndryshme në pronësi shtetërore, kushtet e dhënies së këtyre kontratave për periudhën 2001 e në vijim dhe procedurat për fillimin e punimeve për ndërtimin e TEC-it të Vlorës", anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.  
**Karriera politike:**

1994 e vazhdim: anëtar i PDK-së; 2005(gusht): Sekretar i Përgjithshëm i PDK-së.

**Karriera jopolitike:**

1983-1987: inxhinier ndërtimi në N.N., Mat; 1987-1992: Kryeinxhinier në N.N., Mat; 1992-1995: drejtor i Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave, Mat; 1995 e vazhdim: administrator "Ulza-Ndërtim", sh. p. k. Mat.

## SKUQI, Luan



Datëlindja: 25.10.1951  
Vendlindja: Kavajë  
Zona Nr.: 5 -  
Kavajë  
Qarku: Tiranë

**Adresa:**

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 232602*

**Grupi Parlamentar: PD**

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, anëtar.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (anëtar zëvendësues).

Komisioni Hetimor "Për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, z. Theodhori Sollaku", anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, dega Matematikë; Kolegji i Lartë i Ministrisë së Mbrojtjes.

**Karriera politike:**

1991-1993 dhe 1997-2001: kryetar i Degës së PD-së, Kavajë; 1991 e vazhdim: anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së; 1997 (mars-korrik): ministër i Arsimit, Rinisë e Sporteve; Shtator 2005 - Prill 2007: Anëtar i Komisionit për Politikën e Jashtme.

**Karriera jopolitike:**

1975-1976: mësues, Kukës; 1976-1990: mësues në Lekaj, Kavajë; 1990-1991: mësues, Shkolla e Mesme Kavajë.



## SOLIS, Leonard



Datëlindja: 13.12.1962  
Vendlindja: Leskovik  
Zona Nr.:  
Lista shumemërore

*Adresa:*

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234610*

**Grupi Parlamentar:** Qendra Demokrate – Nënkyetar.

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, anëtar.  
**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë - 1982-1987; specializim pasuniversitar, diplomë për "Sëmundje të brendshme" - 1991-1993.

**Karriera politike:**

1992-1996: Sekretar i Përgjithshëm i PBDNJ-së; 1996-2001: anëtar i Kryesisë së PBDNJ-së, sekretar i Marrëdhënieve me Jashtë; 2001 e në vazhdim: Sekretar i Përgjithshëm i PBDNJ-së.

**Karriera jopolitike:**

1987-1992: spitali Kolonjë; 1991-1993: specializim pasuniversitar – Tiranë; 1993-1995: spitali Ersekë; 1995-1997: Urgjenca Qendrore, Tiranë; 1997-2001: Ministër i Shëndetësisë dhe Ambjentit; 2001-2002: Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit; 2002-2004: këshilltar i Kryeministrit; 2004- 2005 (gusht): Ministër i Shëndetësisë.

## SPAHO, Edmond



Datëlindja: 14.11.1958  
Vendlindja: 84  
Qarku: Korçë

*Adresa:*

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234612*

**Grupi Parlamentar:** PD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat - Kryetar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik - 1982; Instituti i FMN-së, Uashington D.C., USA: Studime për Politikat dhe Programimin Financiar - 1992; Bowling Green State University, Bowling Green, Ohio, USA: studime pasuniversitare në Administrim Biznesi - 1996; Studime për Zhvillimin e OJQ-ve, Leadershipin dhe Planifikimin Strategjik, ORT/USAID Albania Democracy Network Program - 1999.

**Karriera politike:** Maj 2006 - Tetor 2006: Nënkyetar i Komisionit Hetimor për Hetimin e Shkarkimeve në Administratë.

2005 e vazhdim: anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së; anëtar i Kryesisë së PD-së; 2001 e vazhdim: sekretar për Politikat Ekonomike në PD; 1998-2005: Drejtor Ekzekutiv në Qendrën Kombëtare të Trajnimit dhe Asistencës Teknike; 1993-1994: Ministër i Turizmit; 1992-1993: Zv/ministër i Turizmit.

**Karriera jopolitike:**

1991-1992: drejtor i Drejtorisë Makroekonomike në Ministrinë e Ekonomisë; 1988-1991: Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit; 1987-1988: shef i Sektorit Ekonomik dhe Financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave të Shtetit; 1986-1987: shef i Sektorit Financiar në Drejtorinë e Rezervave të Shtetit, Rrëshen; 1982-1986: ekonomist në Drejtorinë e Rezervave të Shtetit, Elbasan.



## STAFJA, Bukurosh



Datëlindja: 26.7.1951  
Vendlindja: Elbasan  
Zona Nr.: 55  
Qarku: Elbasan

**Adresa:**

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit", Tiranë  
Tel.: 00355 4 234607*

**Grupi Parlamentar:** QLD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, sekretar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, dega Inxhinieri Metalurgjike.

**Karriera politike:**

2005: deputet i PS-së; 1992: anëtar i Komitetit Drejtues të PS-së; 1992 dhe 1996: kandidat për deputet i PS-së.

**Karriera jopolitike:**

Inxhinier metalurg në Uzinën e Çelikut, Elbasan; 1983-1989: kryeinxhinier i Kombinatit Metalurgjik, Elbasan; 1989-1992: drejtor i Kombinatit Metalurgjik, Elbasan; 1992-1997: afarizëm privat; 1997-1999: drejtor i Uzinës së Ferrokromit, Elbasan; 1999: drejtor i ALBKROM, Tiranë; 2000-2005: drejtor i Unionit Financiar, Prishtinë.

**Tituj:** Doktor i Shkencave

## STAROVA, Arian



Datëlindja: 26.9.1954  
Vendlindja: Elbasan  
Zona Nr.:  
Lista shumëmemërore

**Adresa:**

*Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e  
Kombit"  
Tiranë  
Tel/Fax:  
00355 4 228526*

**Grupi Parlamentar:** PD

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Këshilli për Legjislacionin – Anëtar.

Komisioni për Politikën e Jashtme – Sekretar.

Maj 2007-... : Anëtar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

Komisioni i Posaçëm për Integrimin në NATO, anëtar.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike e Juridike, dega Filozofi - 1978; Fakulteti i Drejtësisë - 1998; studime për Sigurinë në Senior Executive Seminar në Qendrën George C. Marshall, Garmisch-Partenkirchen, Gjermani - 2005 (gushtator).

**Karriera politike:**

1995-1998: nënkryetar i Partisë Bashkimi Socialdemokrat; 1997 (mars-gusht): Ministër i Punëve të Jashtme të RSH-së; 1997-2001: Kryetar i Bordit i Institutit Shqiptar të Studimeve Ndërkombëtare; 1998-2005: nënkryetar i Partisë Bashkimi Liberal Demokrat; 2002 e vazhdim: President i Shoqatës Shqiptare të Atlantikut; 2003 e vazhdim: anëtar i Bordit Këshillues "Szeged Centre for Security Policy" (Hungari); 2005 (janar) e vazhdim: kryetar i Partisë Bashkimi Liberal Demokrat; 2005: deputet i PBLD.



### Karriera jopolitike:

1977-1978, mësues në Shkollën e Mesme Funar Elbasan; 1979 (mars-gusht): mësues në Shkollën e Mesme pa shkëputje nga puna të "Kombinatit Metalurgjik", Elbasan; 1979-1981: mësues i Filozofisë në Shkollën e Mesme të Përgjithshme "Dhaskal Todri", Elbasan; 1981-1990: pedagog i Filozofisë në Fakultetin e Shkencave Politike e Juridike të UT; 1990-1991: përgjegjës i Katedrës së Filozofisë në Fakultetin e Shkencave Politike e Juridike të UT; 1991-1992: përgjegjës i Katedrës së Etikës e Estetikës në Fakultetin e Shkencave Politike e Juridike të UT; 1991-1992: Zëvendësdekan i Fakultetit të Sociologjisë e Filozofisë, UT; 1992-1997: Zëvendësministër i Punëve të Jashtme; prej 1994: anëtar i Kryesisë së Shoqatës Shqiptare të Atlantikut.  
Tituj: Doktor i Shkencave.

**Publikime:** Artikuj, studime, intervista e botime të shumta për çështjet e politikës së jashtme, sigurimit ndërkombëtar e rajonal, në median shqiptare e të huaj

Librat "Për Kosovën, çështjen kombëtare të shqiptarëve", 2000; "Ndihmesë modeste për demokracinë", 2002; "Në hapësirat e politikës së jashtme e të diplomacisë", 2004. Përkthime artistike e politike.

---

## STEFA, Rajmonda



Datëlindja: 30.9.1957  
Vendlindja: Fier  
Zona Nr.: 72  
Qarku: Fier

*Adresa:*  
Kuvendi i Shqipërisë  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"  
Tiranë  
Tel.: 00355 4 234610

**Grupi Parlamentar:** PSSH

**Veprimtaria parlamentare aktuale:**

Byroja e Kuvendit - Sekretare për Buxhetin.

Sekretariati për Buxhetin - Sekretare.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, anëtare.

**Edukimi:** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë; kurs pasuniversitar për përditësimin e njohurive; trajnime brenda dhe jashtë vendit për problemet gjinore; trajnim "Mbi ngritjen e kapacitetit të grave në qeverisjen vendore", Austri-Shqipëri.

**Karriera politike:** 1991: anëtare e PSSH-së; 1991-1997: anëtare e Kryesisë dhe Komitetit Drejtues të PS-së, Fier; 1992-1996: anëtare e Këshillit të Rrethit, Fier; 1996-2000: anëtare e Këshillit Bashkiak, Fier; 1996-2005: anëtare e Forumit të Gruas Socialiste të Shqipërisë; 2003: anëtare e Këshillit të Njësisë Bashkiake Nr.7, Tiranë; 2003 e vazhdim: anëtare e KPD-së së PSSH-së.

